

# 22

## VITE

### KOMPANIA QË KONTRIBUON NË ÇDO SFIDË



Botim Special: 22 shkurt 2021

#### AVNI PONARI

Si e themelova SIGAL 22 vjet më  
parë, sfidat dhe çelësi i suksesit

#### SIGAL UNIQA

1999-2020  
SFIDAT DHE SUKSESET

#### PËRZGJEDHJA DHE MENAXHIMI I STAFIT

OBLIGIM DHE KËNAQËSI

#### PËRGJEGJSHMËRI

Vëmendje të veçantë komunitetit,  
artit, kulturës dhe sportit në vend

#### OPINION

COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE  
DHE EFEKTET NË EKONOMI

#### TREGU SHQIPTAR I SIGURIMEVE

Si ka ndryshuar pas 22 viteve?



## SIGAL UNIQA, KOMPANIA QË KONTRIBUON NË ÇDO SFIDË



## PËRMBAJTJA


- 04 **PARATHENIE MBI SIGAL:** SIGAL UNIQA, kompania që kontribuon në çdo sfidë
- 05 **DY FJALË PËR SIGAL UNIQA:** Andreas Brandstetter, CEO i Uniqa Group
- 07 **AVNI PONARI:** Si e themelova SIGAL 22 vjet më parë, sfidat dhe çelësi i suksesit
- 09 **SIGAL UNIQA 1999-2020**
  - 1999 - THEMELIMI I SIGAL
  - 2003 - 2006 - ZGJERIM RAJONAL
  - 2004 - "SHTËPI E RE"
  - 2007 - PJESE E UNIQA GROUP AUSTRIA
  - VITI 2009 - 10 VJETORI
  - VITI 2011 - ZGJERIM RAJONAL & LICENSIMI I FONDIT TE PENSIONEVE
  - VITI 2012 - ARMET E SKENDERBEUT NE TIRANE
  - VITI 2017 - 10 VJET SIGAL & UNIQA
  - VITI 2019 - SIGAL UNIQA Group Austria 20 VJEÇ
  - 2020 - SIGAL UNIQA, kompania që kontribuon në çdo sfidë
- 22 **EDVIN HOXHAI:** Misioni i shoqërive të sigurimit të Jetës në SIGAL UNIQA është ofrimi i sigurisë financiare
- 24 Përzgjedhja dhe menazhimi i stafit në 22 vjet obligim dhe kënaqësi
- 25 **SHËRBBIMI NDAJ KLIENTËVE**
- 26 Aktiviteti i SIGAL UNIQA në nivelet e kërkesave të rregullatorit Austriak dhe të ligjeve të BE-së
- 27 **MISIONI I SIGAL UNIQA**
- 28 **ELVIS PONARI:** PENSIONI VULLNETAR, INVESTIMI MË I MIRË PËR VETEN
- 30 **PRODUKTE TË REJA**
- 32 **INOACION**
- 34 **PËRGJEGJËSIA SOCIALE**
- 39 **VLERËSIME:** Për SIGAL UNIQA Group Austria dhe për drejtuesin e SIGAL UNIQA, AVNI PONARI
- 41 **OPINION:** COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE DHE EFEKTET NË EKONOMI
- 43 **TREGU SHQIPTAR I SIGURIMEVE:** Si ka ndryshuar pas 22 viteve?

## SIGAL UNIQA 1999-2020



## OPINION: AVNI PONARI

COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE DHE EFEKTET NË EKONOMI



## TREGU SHQIPTAR I SIGURIMEVE

Si ka ndryshuar pas 22 viteve?



### SIGAL UNIQA Group Austria

Themeluar më 22 shkurt 1999

Grup rajonal me 8 kompani sigurimi, risigurimi dhe Fond Pensioni Privat

Operojmë në 3 shtete:  
Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut

Që prej vitit 2002 udhëheqim tregun shqiptar me rreth 30%

mbi € 72 milionë Prime/vit

€ 121.2 milionë Asete

€ 300 milionë dëme të paguara ndër vite

1,000,000 klientë

1 600 punonjës dhe agjentë

Mbi 1200 zyra në 3 shtete

Të parët në blerjen online të siguracioneve

E vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimit



# PARATHËNIE

## SIGAL UNIQA, KOMPANIA QË KONTRIBUON NË ÇDO SFIDË

Viti 2020 nisi furishëm me ngjarje të pazakonta për mbarë globin dhe na sfidoi të gjithëve. Një virus i rrezikshëm për jetën, i quajtur SARS COV 2 gjunjëzoi jo vetëm një vend të vogël si Shqipëria, por edhe qeveritë dhe ekonomitë më të mëdha botërore.

Kjo ishte një ngjarje përtej çdo imagjinate dhe kostoja në jetë njerëzish deri më tani arrin në miliona njerëz. Shifrat e humbjes ekonomike shkojnë me trilionat dollarë në gjithë globin, ndërsa humbjet vazhdojnë të thellohen nga dita në ditë.

Për Shqipërinë sëmundja e shekullit e quajtur COVID 19 ishte dërmuese, duke patur parasysh ekonominë e brishtë që kemi, dhe pa harruar këtu që vendi ynë vinte nga një goditje e fortë njerëzore dhe ekonomike për shkak të tërmeteve të fundvitit 2019.

Në ngjarje si këto që i kalojnë përmasat njerëzore askush nuk mund të bëjë heroin por ama gjithkush duhet të dijë të bëjë detyrën e tij.

Të përgjegjshëm për detyrimet kontraktuale dhe të ndjeshëm për ngjarjet që prekën të gjithë komunitetin SIGAL UNIQA Group Austria

tregoi edhe njëherë se ajo është jo vetëm kompania lider në sigurime, por është lider edhe kur bëhet fjalë për tu gjendur pranë jo vetëm klientëve të saj por gjithë komunitetit shqiptar brenda dhe jashtë kufijve.

Me dorën në zemër dhe dëshirën e mirë për të kontribuar sadopak për familjet shqiptare që u prekën nga tërmetet e fundvitit që lamë pas, SIGAL UNIQA dhuroi 60 mijë euro, një shumë sa simbolike por aq edhe domethënëse, që na tregon të gjithëve se duke kontribuar të gjithë nga pak, në fund bëhet shumë.

Menjëherë pas tërmeteve SIGAL UNIQA identifikoi të gjithë klientët e saj të prekur nga tërmetet dhe në një kohë rekord dëmshpërbleu dhjetëra familje dhe biznese me vlerë mbi 12 milionë euro.

Në shenjë solidarizimi për të gjithë shqiptarët e prekur nga COVID 19, por edhe si shenjë e mbështetjes dhe falënderimit për punën e jashtëzakonshme të bluzave të bardha, SIGAL UNIQA dhuroi një aparat portativ radiologjik për Spitalin Shefqet Ndroqi Tiranë, duke vënë kështu një tullë të vogël në murin e madh që duhet ngritur për të luftuar këtë

virus të tmerrshëm.

Përtëndihmuar dhe lehtësuar sa më shumë qytetarët të cilët kishin nevojë për këshilla mjekësore, por që ngurrnin të shkonin nëpër spitale për shkak të situatës nga COVID 19, në muajt mars-prill që përkonin me fillimet e pandemisë, SIGAL UNIQA vuri në dispozicion të çdo shqiptari, krejtësisht falas, platformën më të re të mjekësisë online Telefono një Mjek.

Duke instaluar falas aplikacionin "Telefono një Mjek" me qindra qytetarë u këshilluan online 24 orë për simptomat e COVID 19 por edhe për sëmundje të tjera me mjekët më të mirë specialistë të fushës.

2020-a ishte padyshim një nga vitet më të vështira që shqiptarët, dhe jo vetëm, kanë kaluar.

**Me dëshirën dhe besimin që do ti kalojmë së bashku dhe sa më shpejt këto sfida të mëdha, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet partneri juaj për një jetë më të mirë dhe më të sigurtë së bashku.**

# DY FJALË PËR SIGAL UNIQA

## ANDREAS BRANDSTETTER CEO I UNIQA INSURANCE GROUP



ANDREAS BRANDSTETTER  
CEO, UNIQA INSURANCE GROUP

20 vjet më parë SIGAL UNIQA nuk ekzistonte. Avni Ponari, së bashku me një grup të vogël njerëzish, vendosi që të ngrejë një kompani nga hiçi, kompani e cila sot është shndërruar në një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, që mbështet miliona njerëz për të patur një jetë më të mirë, më të gjatë dhe më të sigurtë.

Por çfarë nevojitet për ta arritur këtë? Duhet ta duash atë që ndërton e mbi të gjitha duhet ti duash njerëzit dhe të tregosh kujdes dhe interes për jetën e tyre. Nuk duhet ti kthesh shpinën por duhet ta shohësh në sy klientin, duhet të tregosh interes tek ëndrrat dhe shpresat e tyre. Këtë bën SIGAL dhe dhe kjo e bën këtë kompani kaq të madhe dhe të veçantë.

Jemi kaq të lumtur që kemi SIGAL UNIQA si pjesë të familjes tonë europiane, nga Zvicra deri në Rusi.

Shqipëria është një vend me një popullsi të re dhe ky fakt na bën të mendojmë se këtu ka hapësirë që njerëzit të ndërtojnë dhe të sigurojnë të ardhmen e tyre.

UNIQA Group është një kompani me eksperiencë



200-vjeçare dhe nuk është vetëm kompani austriake, por edhe europiane e ndërkombëtare, dhe kompania SIGAL po kontribuon në një përbindje të lartë në suksesin e grupit tonë.

Gjëja më e rëndësishme për të cilën jemi shumë krenarë është kur para disa vitesh Avni Ponari na kërkoi që të bashkëpunonim me SIGAL. Nëse do të ktheheshim pas në kohë, unë do të thosha pa asnjë mëndyshe: PO, do të merrnim të njëjtin vendim, do të investonim sërish tek SIGAL në mënyrë absolute.

Janë mbi 1600 punonjës energjikë, me në krye një staf drejtues vizionar që kujdesen përkëtë kompani. SIGAL UNIQA është një kompani progresive, moderne e dinamike, e cila nuk rri e fle gjumë dhe pret që diçka të ndodhë, por përpiket të influencojë mjedisin e tij dhe të vendosë standarte.

**SIGAL UNIQA është një kompani që përballlet me çdo sfidë dhe kontribuon në çdo sfidë të shoqërisë. Këtë e dëshmoi mjaft mirë edhe me dy sfidat e fundit, të tërmeteve dhe pandemisë së COVID 19, ku ishte dhe vazhdon të jetë krah klientëve por edhe qytetarëve të saj. Prandaj dhe ne jemi më tepër se kurrë krenarë që kemi në familjen tonë europiane të sigurimeve një kompani si SIGAL UNIQA, e cila jo vetëm merr por edhe i kthen mbrapsht shoqërisë.**

### UNIQA GROUP

Zotëron rreth 87% të aksioneve të SIGAL

Mbi 200 vjet histori dhe përvojë në Europë

Zotëron 21% të tregut Austriak

18 shtete Europiane

40 kompani sigurimi

€ 7.8 mld prime të shkruara

€ 33 mld asete

25 mln kontrata

15.5 mln klientë

21.3 mijë punonjës

I pari investitor strategjik në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon

# AVNI PONARI

## SI E THEMELOVA SIGAL 22 VJET MË PARË, SFIDAT DHE ÇELËSI I SUKSESIT

“

Vetëm 2 vjet pas themelimit të SIGAL, me shumë punë dhe shumë këmbëngulje, pa u dorëzuar në asnjë moment pavarësisht sfidave të mëdha dhe kompanive të tjera që po themeloheshin, arritëm të kryesonim tregun me 30%, shifër të cilën që prej vitit 2002 vazhdojmë ta mbajmë krenarisht edhe sot, pavarësisht shtimit të numrit të kompanive të sigurimit.

”

Kur e nisëm rrugëtimin, bashkë me bashkëudhëtarët e mi të fillimit, që vazhdojmë të jemi edhe sot së bashku, nuk ishte e lehtë, sepse po ecnim në një zonë të minuar, kjo për shkak të mungesës së eksperiencës së sigurimeve në Shqipëri, mungesës së infrastrukturës, mungonte kapitali, baza ligjore dhe çdo gjë tjetër.

Sot nuk mund të konceptohen dot këto gjëra, por 22 vite më parë, kur Shqipëria vinte nga një vend komunist dhe kalonte në një ekonomi tregu të hapur pa patur një model për tu ndjekur,



pa patur ekspertizë dhe mbështetje europiane siç e kemi sot, pa patur një kulturë sigurimesh në popullsi, duhet konsideruar si një guxim shumë i madh të ndërtoje një kompani sigurimesh private. Dhe unë së bashku me katër bashkëudhëtarët e mi të fillimit, të cilët i kisha patur kolegë më herët në kompaninë shtetërore dhe mund të them që jam me fat që arrita ti bind që ti bashkohen idesë time, dhe së bashku ndërtuam të parën kompani private të sigurimeve në Shqipëri, e cila rezultoi të ishte një sukses falë punës dhe përkushtimit të të gjithëve ne, por edhe të qindra punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që na u bashkuan rrugës.

Kur e nisi punën SIGAL ishte në disavantazh me kompaninë e vetme shtetërore të asaj kohe, sepse SIGAL e nisi punën në një zyrë të vogël në Bulevardin Zogu I, me vetëm 5 persona dhe një kapital prej 400 mijë dollarësh. Ndërsa përballë kishte një kompani shtetërore me 1500 punonjës të gjithë me disa vite eksperiencë dhe me një kapital dhjetëra herë më të madh sesa ne.

Por kjo nuk na dekurajoi ne. Përkundrazi, ishte një motiv më tepër për të punuar fort dhe për të arritur objektivat tonë.

Vetëm 2 vjet pas themelimit të SIGAL, me shumë punë dhe shumë këmbëngulje, pa u dorëzuar në asnjë moment pavarësisht sfidave të mëdha dhe kompanive të tjera që po themeloheshin, arritëm të kryesojmë tregun me 30%, shifër të cilën që prej vitit

2002 vazhdojmë ta mbajmë krenarisht edhe sot, pavarësisht shtimit të numrit të kompanive të sigurimit (11 kompani) dhe shtimit të investimeve të huaja në Shqipëri.

22 vjet më parë ishte shumë e vështirë jo vetëm të futeshe në treg, por ta ndërtoje tregun, sepse deri në ato momente ekzistonin vetëm sigurimet e makinave, të marinës dhe aviacionit dhe asgjë tjetër. Ndaj, ne na është dashur që të ndërtojmë një treg sigurimesh të diversifikuar, të krijonim

“ Nëse do të evidentoja çelësin e suksesit në gjithë këto vite, do të veçoja pagesën në kohë të dëmeve dhe shërbimin me korrektësi ndaj klientëve. Çdo klient është i rëndësishëm për kompaninë, dhe nëse neglizhon qoftë edhe një klient të vetëm, atëherë dëmin më të madh nuk ja ke shkaktuar klientit por vetes, pra kompanisë. ”

ekspertizën, bazën ligjore, të krijonim produkte të reja duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të klientëve.

Unë mund ta konsideroj veten dhe kolegët e mi me fat, sepse në vitet e para të tregut të sigurimeve, kur eksperiencia ndërkombëtare mungonte në Shqipëri, ne kemi patur fatin që të trajnohem nga ekspertët më të mirë të sigurimeve në Europë dhe botë, siç është Lloyd's of London, Swiss Re, Munich Re dhe kompani amerikane më të mirat e çdo kohe.

Nëse do të kishte një meritë të veçantë që mund ti jepnim sot SIGAL, krahas ndërtimit të një ekspertize dhe përvoje të tregut në tërësi, është që futi të parin investitor të huaj dhe strategjik në Shqipëri, fillimisht Fondin Shqiptaro-Amerikan të Investimeve dhe më pas UNIQA Group Austria. Këto dy momente shënuan një kthesë të madhe jo vetëm në historinë e SIGAL, por në të gjithë tregun shqiptar të sigurimeve, sepse bashkë me investimet, Fondi Amerikan dhe UNIQA Group sollën gjithë ekspertizën dhe standartet europiane e amerikane në vendin tonë.

Kjo solli një standartizim të tregut në Shqipëri dhe një përmirësim e rritje të shërbimit ndaj klientëve, duke u ofruar atyre produkte dhe shërbime me standarte europiane.

Nëse do të evidentoja çelësin e suksesit në gjithë këto vite, do të veçoja pagesën në kohë të dëmeve dhe shërbimin me korrektësi ndaj klientëve. Çdo klient është i rëndësishëm për kompaninë, dhe nëse neglizhon qoftë edhe një klient të vetëm, atëherë dëmin më të madh nuk ja ke shkaktuar klientit por vetes, pra kompanisë.

Me këtë moto, jemi përpjekur të bëjmë më të mirën dhe sot pas 22 vitesh punë e sakrificë mund të themi që jemi krenarë që SIGAL UNIQA është jo vetëm kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë, por në grupin e 18 kompanive ku operon UNIQA, renditet si një nga 5 kompanitë më të mira në rajon, duke lënë pas edhe vende të zhvilluara sa i përket ekonomisë dhe sigurimeve.



### SIGAL - DO TË THOTË 'SIGURACIONI SHQIPTAR'

Emër ky i ka ardhur në mendjen e themeluesit dhe drejtuesit të kompanisë SIGAL, Avni Ponari, në vitet '97-'98 kur po mendonte të themelonte një kompani private sigurimesh.

Ponari mund të konsiderohet ndoshta dhe i pari person që e kishte menduar këtë iniciativë për tregun privat, që në gjenezë të liberalizimit të tregut në Shqipëri.

Pas 2 vitesh rrahje mendimesh dhe diskutimesh dhe pas një pune të lodhshme me bashkëpunëtorët e tij të fillimit, Avni Ponari ja doli që në ato kohë të vështira për Shqipërinë, të themelonte në 22 shkurt 1999 kompaninë e sigurimeve SIGAL.

Sfidat ishin të shumta dhe të llojeve të ndryshme, por Ponari së bashku me bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë nuk u dorëzuan kurrë.

SIGAL e nisi punën me vetëm 5 persona, një kapital prej 400.000 dollarësh dhe me një zyrë të vogël në bulevardin Zogu I, aty ku sot ndodhen Dega e SIGAL për Tiranën.

Shumë shpejt kompania filloi të rritej si në numër punonjësish ashtu edhe në numër kontratash dhe në cilësinë e shërbimit. Në fund të vitit të parë të themelimit (1999) SIGAL numëronte 22 punonjës, 40 agjentë, 4110 kontrata dhe

13,200,000 lekë dëme të paguara.

Në të njëjtin vit, SIGAL përballet me dëme të konsiderueshme të ndodhura në sigurimin e Marinës (transport detar) dhe kryen menjëherë procedurat e dëmshpërblimit, duke rritur kështu sigurinë dhe besimin tek klientët e saj.

Drejtuesi i SIGAL dhe stafi fillestar, të cilët për kohën kishin të gjithë mbi 5 vite eksperiencë në sigurime, bënë që shpejt të ndërtonin marrëdhënie bashkëpunimi të ngushta me partnerët risigurues, përmes Marsh Inc, që është risiguruesi më i madh në botë, duke i mundësuar SIGALit të shfrytëzonte njohuritë, eksperiencën dhe kapacitetet financiare të tregut botëror, duke i vënë në dispozicion shoqërisë SIGAL resurse të pakrahasueshme për kohën.

Një tjetër bashkëpunim shumë

me interes ishte me Coris International, me qendër në Paris. SIGAL dhe Coris krijuan një shoqëri të përbashkët të emërtuar Coris Albania, shoqëri trajtuese dëmsh dhe asistencë për klientët në territorin e Shqipërisë, në emër dhe për llogari të grupit Coris International.

SIGAL bëri të mundur zgjerimin e tregut të sigurimeve të Marinës në Shqipëri, falë bashkëpunimit që lidhi me klubet lundruese të Marinës P&G (West of England Steamship), duke u bërë përfaqësuesi i tyre i autorizuar për Shqipërinë.



(Nga e majta ulur)  
Themeluesi i Kompanisë SIGAL sh.a., Z. Avni Ponari  
Drejtori i Marrjes në Sigurim Z. Edvin Hoxhaj  
Stafi Drejtues: Franc Gjoka, Alma Totokoci,  
Saimir Dhama, Ditika Kruja





ZGJERIM  
RAJONAL


2003

SIGAL lider i tregut të sigurimeve dhe zotëron 31% të tij. Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve u bë aksioneri i parë i huaj. Gjithashtu SIGAL zgjeroi aktivitetin në Kosovë përmes SIGAL Kosova.



2004

Në 5-vjetorin e aktivitetit të saj SIGAL forcon edhe më shumë pozitën. Themelohet SIGAL Life e cila ofron sigurimet e jetës në Shqipëri si dhe nis aktivitetin në Maqedoni përmes themelimit të SIGAL Maqedoni.



2005

Bordi Drejtues i Fondit Amerikan vizitoi zyrat e SIGAL. Gjithashtu, përgjatë këtij viti u zhvilluan Konferenca Rajonale dhe Analiza Financiare ku u diskutuan ide zhvillimi mbi tregun e sigurimeve.



2006

Një kompani e re i shtohet grupit! Krijohet e para dhe e vetmja kompani risigurimi në rajon, SIGAL Risigurime



SIGAL e nisi punën në një zyrë të vogël, 200 metra larg zyrave qendrore aktuale dhe që nga ajo kohë SIGAL ka pësuar ndryshime rrënjësore dhe ka njohur vetëm rritje nga vit në vit.

Vetëm 3 vjet pas themelimit, SIGAL u rendit në krye të tregut të sigurimeve në Shqipëri me 31%, pozicion të cilin e ka mbajtur dhe vazhdon ta mbajë krenarisht përgjatë gjithë viteve, pavaërisht shtimit të numrit të kompanive të sigurimit në treg, ku sot numërohen 12 kompani sigurimi jetë dhe jo-jetë.

Viti 2003 ka një rëndësi të veçantë për SIGAL, sepse arrin të tërheqë të parin investitor të huaj të investonte në tregun e sigurimeve vendas.

Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, investoi tek SIGAL, duke blerë 13.3% të aksioneve.

Në të njëjtin vit, më 23 tetor, SIGAL përfundon të gjitha marrëveshjet dhe realizon blerjen e kompanisë së sigurimeve Drini në Kosovë, duke themeluar kështu SIGAL Jo-Jetë në Kosovë dhe më pas zgjerohet edhe me kompaninë Sigal Jetë.

Dy kompanitë e sigurimeve, SIGAL Shqipëri dhe SIGAL Kosovë krijuan një marrëveshje dhe mundësuan lëvizjen e lirë të automjeteve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Pra mjetet e Kosovës hynin në Shqipëri dhe ato të Shqipërisë hynin në Kosovë pa paguar asgjë.

Sigurimi i Shëndetit dhe Aksidenteve ishte prioritet i produkteve për vitin 2003 dhe SIGAL ka meritën e të qenurit e para kompani sigurimesh në Shqipëri, e cila u ofroi klientëve produktet e sigurimit të shëndetit.



Më 22 shkurt 2004 SIGAL mbushi 5 vjeç. 5-vjetori e gjeti kompaninë me "shtëpi" të re. Drejtoria e Përgjithshme e SIGAL u transferua në zyrat e reja në hyrje të bulevardit "Zogu I", sot godina e "SIGAL Business Center", ndërsa zyrat e fillimit u zgjeruan dhe u shndërruan në Degën e SIGAL për Tiranën.

Në të njëjtin vit SIGAL, ishte e para dhe e vetmja kompani, e cila fitoi të drejtën e ofrimit për klientët të të gjitha klasave të sigurimit.

SIGAL tanimë nuk njeh kufij. Në vitin 2004, SIGAL zgjerohet dhe shtrin aktivitetin edhe në Maqedoni, ndërsa në Shqipëri, dy vite më vonë, krijon një tjetër kompani, atë të sigurimeve të jetës si dhe hap të parën dhe të vetmen kompani Risigurimi në Shqipëri, duke u shndërruar kështu në një grup rajonal sigurimesh me të gjitha llojet e produkteve të sigurimit.

"SIGAL Risigurime" vazhdon të mbetet e para dhe e vetmja kompani risigurimi në Shqipëri, që prej themelimit të saj në vitin 2006.

SIGAL organigrama  
SIGAL Shqipëri Jetë  
SIGAL Shqipëri Jo-Jetë  
SIGAL Kosovë Jetë  
SIGAL Kosovë Jo-Jetë  
SIGAL Maqedoni Jo-Jetë





2007

Pjesë e UNIQA Group AUSTRIA!  
Gjigandi evropian i sigurimeve UNIQA  
Group AUSTRIA blen 45.64% të aksioneve  
të kompanisë.

PJESË E  
UNIQA

### Viti 2007 pati një sërë zhvillimesh të rëndësishme për SIGAL.

Në 23 mars, SIGAL bëhet pjesë e një prej grupeve financiare më të rëndësishme në Europën Qendrore-Lindore, UNIQA Group Austria.

UNIQA, me shtrirje në atë kohë në 13 shtete europiane, dhe kompani me histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve të Europës, kishte shprehur interes që të hynte në tregun e Shqipërisë dhe Kosovës dhe të investonte në këto tregje.

Nga hulumtimi dhe studimi që drejtuesit e UNIQA-s i kishin bërë tregut në Shqipëri, konkluduan që SIGAL ishte e vetmja kompani që përmbushte të gjitha kriteret e menaxhimit, stafit, aseteve, strategjisë, leadershipit dhe çdo elementi që kërkonin tek një kompani për tu bërë partnerë biznesi. Kjo ishte edhe arsyeja se përse UNIQA zgjodhi SIGAL-in për të investuar.

Pas një sërë negociatash që përfunduan me sukses, UNIQA bleu 45.64% të aksioneve të shoqërisë SIGAL, duke u bërë kështu i pari investitor i huaj në

Shqipëri për tregun e sigurimeve.

SIGAL, u riemëruar SIGAL UNIQA Group Austria, dhe nuk mbarti vetëm emrin e grupit të fuqishëm financiar të tregut të sigurimeve në Europë, UNIQA, por mori të gjithë eksperiencën qindra vjeçare të saj dhe standartet europiane të punës, menaxhimit dhe shërbimit ndaj klientëve. Tanimë SIGAL UNIQA, krenarisht, mund të cilësohej si kompani me rrënjë shqiptare por me standarte europiane.

“Për ne ishte një lehtësim shumë i madh, sepse ne tashmë bëheshim garantues për çdo lloj vlere dhe merrnim përsipër të gjitha llojet e rreziqeve, duke përfshirë rreziqet financiare, por edhe rreziqet politike në territorin ku operon SIGAL UNIQA, Shqipëri - Kosovë-Maqedoni, duke i dhënë garanci qytetarëve për të patur një kompani, e cila merr përsipër çdo lloj risku që është në territorin e Shqipërisë dhe vendeve ku ne operojmë”, do të shprehej në një intervistë, Avni Ponari, themelues dhe Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria.

Viti 2007 shënoi një tjetër sukses për SIGAL, sepse



themeloi të parin Fond Pensionesh Private në Shqipëri, një risi kjo në tregun e sigurimeve, ku qytetarët, tanimë më si në çdo vend tjetër të Europës apo botës, mund të kontribuonin për veten e tyre dhe të kishin një pension privat të denjë për moshën e pleqërisë.

Tani SIGAL UNIQA nuk mbetet më vetëm një kompani, por një grup prej 6 kompanish sigurimi jetë dhe jo-jetë, risigurimi dhe pensione private, duke u shndërruar kështu dhe në një nga grupet më të mëdha financiare në rajon.

2008

Forcojmë pozitën në Kosovë dhe Maqedoni.  
SIGAL UNIQA inauguroi zyrat e reja në Shkup duke investuar 1,000,000 euro gjithashtu po këtë vit festoi 5-vjetorin e aktivitetit në Kosovë.





10 VITE  
HISTORI

2009

Në 10 vjetorin e SIGAL, UNIQA blen aksione të tjera duke arritur në 68.64%. Në Maqedoni emri i ri i Kompanisë është UNIQA Shkup.



2010

Dr. Erhard Busek, Koordinator i Paktit të Stabilitetit për Europën Jug-Lindore emërohet Anëtar i Bordit Mbikqyrës të SIGAL UNIQA. Konferenca Rajonale u zhvillua në Vjenë me pjesëmarrjen e personaliteteve të rëndësishme të financave europiane.



### VITI 2009 ISHTE VIT JUBILAR PËR SIGAL UNIQA-N, SEPSE CELEBRONTE PLOT 10 VJET NGJA THEMELIMI.

Me këtë rast u zhvillua një mbrëmje gala në Pallatin e Operas dhe Baletit me interpretimin e sopranos së mirënjohur Inva Mula. Me qindra të ftuar, personalitete të fushave të ndryshme, staf dhe partnerë të SIGAL ishin prezentë në mbrëmje, ndërsa për publikun u transmetua nga televizionet më të mëdha shqiptare.

Një ngjarje e rëndësishme e këtij viti është përfundimi i bashkëpunimit me aksionerin UNIQA, e cila bleu aksione të tjera të SIGAL dhe arriti totalin 68.64%.

Ndërsa në Maqedoni SIGAL u ribrendua në UNIQA a.d, më 14 nëntor 2009.

Në të njëjtin vit, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL, Avni Ponari nderohet nga Bashkia e Durrësit me titullin "Qytetar Nderi i Durrësit".

Ndërkohë që SIGAL rritet dhe fuqizohet, përveç detyrimeve kontraktuale nuk lë mënjane as përgjegjësinë sociale.

Me kërkesë të SIGAL, për t'ju gjendur sa më pranë klientëve të saj por edhe qytetarëve, UNIQA Vital Truck, klinika lëvizëse shëndetësore e UNIQA-s erdhi në Shqipëri dhe për shumë ditë me radhë ofroi ekzaminime shëndetësore falas për banorët e zonave të ndryshme të Shqipërisë.

Klinika e UNIQA-s, e ardhur nga Austria u prit me interes shumë të madh nga klientët e SIGAL UNIQA por edhe nga qytetarët e tjerë, dhe për këtë arsye, me motivin "Më mirë të parandalosh sesa të kurosh", SIGAL UNIQA vendosi që të ndërtojë vetë një klinikë lëvizëse si ajo e UNIQA-s dhe ta vërë në dispozicion të qytetarëve, kryesisht në zonat rurale të Shqipërisë, për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë atyre që ndoshta nuk kanë kushtet për të patur një shërbim shëndetësor cilësor e të vazhdueshëm.





## RAJONAL

2011

Zgjerohet aktiviteti i grupit SIGAL UNIQA: FPP SIGAL Life UNIQA (Pensione Private, Shqipëri), SIGAL Life UNIQA Kosova (Jetë, Kosovë) dhe UNIQA Life Shkup (Jetë, Maqedoni)



2012

Në 100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë mundësuam dhe siguruam ekspozitën e Armëve të Skënderbeut. Teatri Skampa, i siguruar tek SIGAL UNIQA, u rindërtua pas djegies totale.

2013

10 vjet bashkëpunim i frytshëm me Fondin Amerikan dhe 10 vjet sukses i SIGAL UNIQA në Kosovë e cila tashmë operon në zyrat e reja falë një investimi prej 2.5 milionë eurosh.

2015

UNIQA Insurance Group zotëron 86.93% të aksioneve të kompanisë. SIGAL UNIQA vjen me risi, duke ndërtuar të parën Klinikë Lëvizëse Shëndetësore në Shqipëri e cila ofron kontrolle shëndetësore në të gjithë rajonin.

2014

Në 15-vjetorin e SIGAL UNIQA u zhvillua një mbrëmje gala, ku morën pjesë personalitete të larta të politikës dhe financave.

2016

Për herë të parë në Shqipëri SIGAL UNIQA ofron shitjen online të sigurimeve si dhe u vlerësua me 8 çmime ndërkombëtare nga kompani prestigjioze europiane.

## ZGJERIM RAJONAL & LICENSIMI I FONDIT TË PENSIONEVE

SIGAL UNIQA vazhdon rritjen dhe zgjerimin e aktivitetit në tregun shqiptar të sigurimeve si dhe në atë rajonal. Në vitin 2011, SIGAL UNIQA zgjerohet me kompani të reja, duke themeluar në Kosovë SIGAL Life Uniqa si dhe në Maqedoni UNIQA Life Shkup për sigurimet e jetës.

Ndërkohë, Fondi i Pensioneve SIGAL, i themeluar në vitin 2007, licensohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për të zhvilluar aktivitetin konform legjislacionit në fuqi.

Me themelimin e kompanive të reja, grupi SIGAL Uniqa në vitin 2011 numëronte 8 kompani sigurimesh jetë, jo-jetë, pensione dhe risigurime.

Këtë vit SIGAL UNIQA vlerësohet nga Business International Alternative me çmimin "International Gold Star for Quality", ç'ka përforconte edhe më tepër cilësinë e shërbimit dhe standartet e larta të produkteve që SIGAL UNIQA ofronte klientëve të saj.

## ARMËT E SKËNDERBEUT NË TIRANË

Viti 2012 ishte vit jubile i të gjithë shqiptarëve, sepse përkonte me 100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Me këtë rast, SIGAL UNIQA u dhuroi shqiptarëve atë që të gjithë e ëndërronin prej shumë vitesh: Armët e Skënderbeut në Muzen e Tiranës, të hapura për tu shikuar nga të gjithë.

Por e kujt ishte idea dhe si u realizua?

Idea fillestare u hodh nga Andreas Branstetter, CEO i UNIQA Group, gjatë një mbledhje bordime SIGAL në Tiranë. Idea që u përqaftua nga Drejtuesi i Bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, Michael Granoff, një dashamirës i Shqipërisë, u bë motiv për themeluesin dhe drejtuesin e SIGAL UNIQA, Avni Ponari, i cili punoi fort dhe bëri që ëndrra e të gjithë shqiptarëve të bëhej realitet.

Në Austri ishte Brandstetter ai i cili po lobonte fort dhe po punonte me autoritetet që të bindeshin që Armët e Skënderbeut të vinin në Tiranë, nga ana tjetër në Shqipëri ishte Avni Ponari që po punonte me qeverinë e

asaj kohe dhe njëkohësisht po realizonte edhe urat e komunikimit ndërmjet Vjenës dhe Tiranës.

Pas shumë përpjekjesh, pas shumë garancish të një pas njëshme nga ana e autoriteteve përkatëse, por edhe nga vetë Z. Ponari i cili ndërmjet shumë të tjerash realizoi nëpërmjet SIGAL UNIQA edhe sigurimin e koleksionit të armëve në vlerën 35 milionë euro, më 23 nëntor 2013 Armët e Skënderbeut u shpалosën në Muzeun Kombëtar në Tiranë dhe u panë nga mijëra shqiptarë nga brenda dhe jashtë kufijve.

Kjo ishte hera e parë dhe e vetmja deri më tani që armët e Heroit tonë Kombëtar erdhën në Shqipëri.

Me këtë rast, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani, dekoroi CEO-m e UNIQA Group Austria, Z. Andreas Brandstetter, me "Medaljen e Mirënjohjes", për mbështetjen e jashtëzakonshme që UNIQA, dhe në veçanti vetë Brandstetter, në bashkëpunim me SIGAL-in dhanë për ardhjen e armëve të Skënderbut në Muzeun Kombëtar në Tiranë.





10 VJET  
ME  
UNIQA

2017

2017-ta shënoi 10-vjetorin e SIGAL si pjesë e UNIQA Group Austris. Në po të njëjtin vit, u zhvillua në Tiranë, takimi Ndërkombëtar "UNIQA Marketing & PR Days", ku morën pjesë mbi 40 drejtues të UNIQA-s nga 18 shtete europiane.

2018

Forumi Ndërkombëtar UNIQA, me moton 'Mendo që idetë e mëdha ndriçojnë rrugën', ky forum mbledhi bashkë mbi 120 CEO dhe kryetarë bordesh nga 16 -të shtete të Evropës, në Tiranë.

10 VJET SIGAL DHE  
UNIQA

SIGAL dhe UNIQA shënuan 10 vite bashkëpunim, që nga koha e blerjes së aksioneve të SIGAL nga UNIQA Group Austria për herë të parë në vitin 2007.

Me këtë rast u zhvillua një aktivitet dhe një konferencë për mediat në ambientet e Hotel Sheraton në Tiranë.

Në këtë ceremoni të veçantë morën pjesë CEO i UNIQA International, Z. Wolfgang KINDL, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë Z. Avni PONARI, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, SH. T. Z. Johann Sattler si dhe personalitete të larta të biznesit, ekonomisë dhe financave në Shqipëri. SIGAL gëzon meritën për futjen e të parit investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve, i cili pati një ndikim të madh në standartizimin e tregut dhe në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve ndaj klientëve.

Në 10-vjetorin e bashkëpunimit me UNIQA-n, SIGAL hapi për herë të parë dyert e një muzeu krejtësisht të veçantë. "Muzeu i Sigurimeve SIGAL UNIQA", i pari në llojin e tij në të gjithë rajonin, i pozicionuar në zyrat qendrore të kompanisë, muzeu paraqet historikun e SIGAL që nga themelimi në vitin 1999 e në vazhdim.



UNIQA

5 - 7 June 2018

UI Forum

Tirana - Albania

UNIQA

20 VITE  
HISTORI  
SUKSESI

2019

20 vjet histori: Skulptura "MIRËNJOHJE - FALËNDERIME PËR TË GJITHË" u vendos në qendër të Tiranës, shumë pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA. Po në këtë vit Z. Avni Ponarin, i cili u nderua nga Presidenti i Austrisë me dekoratën "GRAND DECORATION OF HONOUR".

SIGAL UNIQA Group  
Austria 20 VJEÇ

Me rastin e 20-vjetorit SIGAL UNIQA ideoi dhe realizoi një vepër, skulpturë, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për klientët, stafin, partnerët dhe të gjithë bashkëdhëtarët e SIGAL UNIQA ndër vite.

Vepra me temën, "MIRËNJOHJE - FALËNDERIME PËR TË GJITHË", u vendos në qendër të Tiranës, në rrugën "Urani Pano", shumë pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA.

"Çdo ditë ne punojmë, rritemi, ecim përpara, rritet biznesi, zgjerohen partnerët, stafi, miqësia, familja, shoqëria, rritet dhe zhvillohet edhe qyteti ku jetojmë dhe vjen një moment kur duhet të ndalemi, të reflektojmë dhe të jemi mirënjohës për çdo gjë që kemi arritur deri më tani dhe tu themi

FALEMINDERIT të gjithë atyre që na rrethojnë dhe që kanë kontribuar në zhvillimin tonë të përbashkët.

Ne nisëm një rrugëtim me pak persona, por rreth nesh na u bashkuan shumë gjatë rrugëtimit tonë, mbi 1500 punonjës e mbi 1 milion klientë. Prandaj dhe sot është momenti që të ndalemi, të kthejmë kokën pas dhe të kujtojmë të gjithë ata që ishin me ne, që nga fillimi, por edhe ata që na u bashkuan rrugës, sepse secili prej tyre ka dhënë një kontribut të veçantë dhe të paçmueshëm për SIGAL-in në radhë të parë, por edhe për zhvillimin dhe progresin individual të tyre por edhe dhe të të gjithë shoqërisë shqiptare.

Sot unë ju them me zemër FALEMINDERIT dhe MIRËNJOHJE të gjithë atyre që na besuan e do na besojnë, ata janë busulla jonë e orientimit", - do të shprehej gjatë ceremonisë së inaugurimit Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Avni PONARI.





## 20 vjet SIGAL UNIQA, Avni Ponari dekorohet me "Grand Decoration of Honour" nga Presidenti i Austrisë

Në një mbrëmje gala, me të ftuar përfaqësues të trupit diplomatik, biznesmenë, artistë, bashkëpunëtorë dhe me pjesëmarrjen e vecantë të CEO-s të UNIQA Group Austria, Z. Andreas Brandstetter, Z. Avni Ponari nderohet me dekoratën "Grand Decoration of Honour"

Për këtë vlerësim nga shteti i Austrisë Z. Ponari u shpreh: "Jam i prekur nga nderimi i Presidentit të Republikës së Austrisë, Shkëlqesia e Tij, Z. Alexander Van der Bellen, që më akordoi medaljen "Grand Decoration of Honor" gjithashtu dhe prania juaj sonte në këtë event të rëndësishëm që përkon me 20 vjetorin e themelimit të SIGAL, më bën të ndjem krenar dhe më i përkushtuar. Përcjell falënderimet e përzemërta dhe mirënjohjen time të thellë Shkëlqesisë së Tij si dhe shtetit të Austrisë për këtë vlerësim që më bënë, nëpërmjet Ambasadorit të Austrisë, Z. Johan Sattler.



2020

Në janar të vitit 2020 Z. Avni Ponari u vlerësua nga Perandori japonez me titullin "The Order of the Rising Sun, Gold Rays With Neck Ribbon" për kontributet e tij të jashtëzakonshëm për promovimin e shkëmbimeve dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore mes dy vendeve

SIGAL  
UNIQA  
SOT

Je tojmë  
më mirë  
së bashku!

### SIGAL UNIQA, kompania që kontribuon në çdo sfidë

Me dorën në zemër dhe dëshirën e mirë për të kontribuar sadopak për familjet shqiptare që u preknë nga tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA dhuroi 60 mijë euro, një shumë sa simbolike por aq edhe domethënëse, që na tregon të gjithëve se duke kontribuar të gjithë nga pak, në fund bëhet shumë. Menjëherë pas tërmeteve SIGAL UNIQA identifikoi të gjithë klientët e saj të prekur nga tërmetet dhe në një kohë rekord dëmshpërbleu dhjetëra familje dhe biznese me vlerë mbi 2 milionë euro.

### SIGAL UNIQA dhuron në emër të jetës

SIGAL nuk do të thotë vetëm siguracione. SIGAL është aty kudo dhe për këdo, duke iu gjendur pranë çdo shqiptari dhe çdo klienti këtij dhe përtej kufijve, kur ata kanë më tepër nevojë.

Në shenjë solidarizimi për të gjithë shqiptarët e prekur nga COVID 19, por edhe si shenjë e mbështetjes tonë dhe falënderimit për punën e

jashtëzakonshme të bluzave të bardha, dhuruam një aparat portativ radiologjik për Spitalin Shefqet Ndroqi Tiranë, duke vënë kështu edhe NE një tullë të fortë në murin e madh që duhet ngritur për të luftuar këtë virus të tmerrshëm.





# MISIONI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT TË JETËS NË SIGAL UNIQA ËSHTË OFRIMI I SIGURISË FINANCIARE

**ME MBI 9 MILIONË EURO TË ARDHURA VJETORE NGA PRIMET, SIGURIMET E JETËS KONTRIBUOJNË ME RRETH 14% NË VEPRIMTARINË E SIGAL / UNIQA.**

Me mbi 9 milionë euro të ardhura vjetore nga primet, sigurimet e Jetës kontribuojnë me rreth 14% në veprimtarinë e SIGAL / UNIQA.

Fillimi i veprimtarisë së sigurimeve të Jetës së SIGAL ishte një zhvillim i natyrshëm i rritjes së shoqërisë dhe zgjerimit të fushës së shërbimeve siguruese.

Me rritjen e veprimtarisë përmes shoqërive të sigurimeve të Jo Jetës në Kosovë e Maqedoni, përkatësisht në vitet 2003 dhe 2004, vëmendja e drejtuesve të shoqërisë u fokusua në zgjerimin e gamës së produkteve siguruese për të plotësuar shërbimet ndaj klientëve.

Pas përfundimit të suksesshëm të fazës së aplikimit, në Korrik 2004 SIGAL-it iu shtua shoqëria e katërt (pas atyre të Jo Jetës në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni), ose shoqëria e parë e sigurimeve të Jetës – SIGAL Life.

Me marrjen e licensës për të gjitha klasat e sigurimeve të Jetës dhe pas një pune intensive përgatitore, shoqëria SIGAL Life filloi veprimtarinë në Shkurt 2005.

Duke u mbështetur në



**EDVIN HOXHAJ**  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA

“ Si pjesë e SIGAL / UNIQA, sigurimet e Jetës plotësojnë gamën e shërbimeve që grupi ofron në këto vende, si produkte të veçanta në platforma të përbashkëta, por edhe si bashkësigurime.

Me mbi 9 milionë euro të ardhura vjetore nga primet, sigurimet e Jetës kontribuojnë me rreth 14% në veprimtarinë e SIGAL / UNIQA. ”

përvojën e suksesshme dhe reputacionin e shoqërisë së sigurimeve SIGAL (Jo Jetë) shoqëria SIGAL Life shumë shpejt kryesoi tregun Shqiptar të sigurimeve të Jetës jo vetëm në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, por edhe në vëllimin e veprimtarisë shprehur në të ardhurat.

Prej vitit 2007 SIGAL Life kryeson tregun e sigurimeve të Jetës në Shqipëri me rreth 60% të tij.

Në vitin 2009 shoqëria ndërkombëtare UNIQA Group filloi pjesëmarrjen aksionere në grupin e shoqërive SIGAL. Kjo shënoi fillimin e një bashkëpunimi tepër të suksesshëm në fushën e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Burimet e mëdha financiare dhe njohuritë e UNIQA Group, kombinuar me përvojën vendore dhe personelin e kualifikuar të SIGAL, mundësuan zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së përbashkët në këto vende, si në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve siguruese ekzistuese, po ashtu edhe të plotësimit të tyre me

shërbimet e sigurimeve të Jetës në Kosovë dhe Maqedoni.

Prej vitit 2011 SIGAL / UNIQA operon suksesshëm në fushën e sigurimeve të Jetës përmes shoqërive përkatëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, si me produkte investimesh, ashtu edhe me produkte të thjeshta e të përshtatshme të sigurimeve të Jetës në grup ose individuale.

Si pjesë e SIGAL / UNIQA, sigurimet e Jetës plotësojnë gamën e shërbimeve që

grupi ofron në këto vende, si produkte të veçanta në platforma të përbashkëta, por edhe si bashkësigurime.

Me mbi 9 milionë euro të ardhura vjetore nga primet, sigurimet e Jetës kontribuojnë me rreth 14% në veprimtarinë e SIGAL / UNIQA.

Misioni i shoqërive të sigurimit të Jetës në SIGAL / UNIQA është ofrimi i sigurisë financiare përmes shërbimeve e produkteve siguruese, duke vendosur dhe ruajtur standarde Europiane në veprimtari.

Sigurimet e Jetës i shërbejnë kërkesave të veçanta të çdo policëmbajtësi, investimit të fondeve që i janë besuar dhe ruajtjen e një veprimtarie të efektshme.

Në përputhje me strategjinë e UNIQA Group në fushën e sigurimeve të Jetës, veprimtaria e sigurimeve të Jetës të SIGAL / UNIQA synon optimizimin e produkteve e shërbimeve dhe fokusimin në sigurimet biometrike.

“ Burimet e mëdha financiare dhe njohuritë e UNIQA Group, kombinuar me përvojën vendore dhe personelin e kualifikuar të SIGAL, mundësuan zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së përbashkët në këto vende, si në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve siguruese ekzistuese, po ashtu edhe të plotësimit të tyre me shërbimet e sigurimeve të Jetës në Kosovë dhe Maqedoni. ”



# PËRZGJEDHJA DHE MENAXHIMI I STAFIT NË 22 VJET OBLIGIM DHE KËNAQËSI

*Padysim që merita, mirënjohja dhe falënderimet më të mëdha i shkojnë stafit, një staf me profesionistë të vërtetë, të përkushtuar ndaj punës dhe të motivuar për të bërë gjithmonë më të mirën.*

22 vite në SIGAL, janë vite të çmuara, me lodhje, sakrificë por edhe me suksese e kënaqësi.

Nëse SIGAL ia ka dalë të jetë kjo kompani lider për gjithë këto vite, padysim që merita, mirënjohja dhe falënderimet më të mëdha i shkojnë stafit, një staf me profesionistë të vërtetë, të përkushtuar ndaj punës dhe të motivuar për të bërë gjithmonë më të mirën.

Në eksperiencën time 22-vjeçare në SIGAL, që prej themelimit kur ishim vetëm 5 persona dhe deri më tani që jemi mbi 1600 punonjës, mund të them që përzgjedhja e stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore është një obligim shumë i madh, i domosdoshëm por mbi të gjitha me përgjegjësi, sepse në fund ai ose ajo që ti ke përzgjedhur do të kontribuojë ose jo në rritjen dhe zhvillimin e kompanisë.

Nga ana tjetër kjo është edhe një punë që të fal kënaqësi, por edhe të mëson. Sepse unë mendoj që çfarëdo pozicioni që ti të kesh, drejtues ose jo, në fund të ditës ne të gjithë mësojmë nga njëri-tjetri, nga eksperiencat tona, nga sukseset apo edhe nga gabimet tona. Ndaj unë mendoj, që fakti që sot SIGAL UNIQA numëron kaq shumë punonjës dhe me një jetëgjatësi mesatarisht 10 vjet, është një tregues suksesi do të thoja modestisht, jo vetëm i punës tonës si drejtues, por mbi të gjitha i kompanisë SIGAL UNIQA Group Austria dhe në veçanti i vetë stafit që arrin të shkrihet dhe të përshtatet mjaft mirë me frymën e kompanisë dhe të lidhshimit.

SIGAL UNIQA i kushton një rëndësi të veçantë trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe kualifikimit progresiv të tyre,



Alma TOTOKOÇI  
Zv. Drejtore e Përgjithshme  
SIGAL UNIQA Group Austria

me qëllim rritjen e produktivitetit por mbi të gjitha rritjen dhe perfeksionimin e shërbimit ndaj klientëve.

Nisur nga kjo, stafi i SIGAL UNIQA, trajnohet nga trajnuesit më të mirë në Europë, sipas fushave dhe departamenteve që mbulojnë, me njohuritë më të fundit mbi sigurimet dhe praktikën e dëmeve.

Krahas zhvillimit profesional, është e rëndësishme që stafi të jetë komod në punën që bën sa i përket faciliteteve që u ofrohet në vendin e punës. Prandaj ne si SIGAL UNIQA i kushtojmë një rëndësi të veçantë edhe kushteve të zyrave, ku mund të them me plot gojën që jemi pothuaj në të njëjtat standarde dhe nivele si ato të kolegëve tanë në Vienë dhe kudo në Europë, sikundër fryma e grupit dhe e bashkëpunimit në SIGAL është shumë e lartë dhe për këtë ndjehem mjaft krenarë. Mendoj që Ne në SIGAL nuk jemi thjeshtë kolegë, por jemi një familje e madhe dhe jemi aty kurdo dhe për çfarëdo për njëri-tjetrin.

Zyrat qendrore të SIGAL UNIQA ndodhen në një godinë strategjike, në qendër të Tiranës, në Qendrën e Biznesit SIGAL, dhe e gjithë godina është në funksion të kompanisë dhe

është e konceptuar si godinë me një ndalesë. Kjo do të thotë që punonjësit kanë brenda godinës çdo shërbim dhe facilitet që u nevojitet, duke filluar që nga ambientet e shërbimit dhe pushimit, tek klubi i shëndetit, klub kulture, konsulencia mjekësore dhe çdo gjë tjetër që u nevojitet.

SIGAL UNIQA është pjesë e UNIQA Group, me seli në Vienë Austri dhe shtrirje në 18 shtete të Europës Qendrore-Lindore. Të qenurit pjesë e një gjigandi sigurimesh si UNIQA, me eksperiencë mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve në Europë, do të thotë të mësosh nga më të mirët.

Ndaj dhe ne jemi krenarë që stafi i SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, vazhdimisht trajnohet nga ekspertët e sigurimeve të UNIQA-s në Vjenë, sikundër një rol të veçantë luajnë dhe shkëmbimet e informacione, praktikave të punës por edhe e kulturës që zhvillohen mes stafit të SIGAL dhe kolegëve të grupit UNIQA në 18 shtetet europiane.

Nisur nga kjo, mund të them me plot gojën, që jemi kompani me rrënjë shqiptare, por me garanci dhe eksperiencë europiane.

# SHËRBBIMI NDAJ KLIENTËVE

**Ne kërkojmë të përdorim produktet dhe shërbimet tona dhe të cilësisë më të lartë sa më mirë që të jetë e mundur për të ndihmuar klientët tanë që të gëzojnë një siguri dhe liri më të madhe në jetët e tyre.**



Mbi 1600 punonjës energjikë, profesionalë dhe me eksperiencë disa-vjeçare u shërbejnë çdo ditë mbi 1 milion klientëve të SIGAL UNIQA në 3 shtete: Shqipëri - Kosovë - Maqedoni e Veriut.

Mbi 1100 zyra dhe pika shitjesh janë në dispozicion të klientëve çdo ditë, për të marrë informacione, për të blerë siguracionet që ju nevojiten si dhe për të hapur praktikën e dëmeve.

Për tu gjendur sa më pranë klientëve, hapëm Qendrën e Asistencës për të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike, për të asistuar çdo klient që të plotësojë si duhet dosjen e dokumentacionit dhe hapjen e praktikës së dëmit, me qëllim që ta

marrin në kohë dhe të plotë dëmshpërblimin që ju takon në rast dëmi nga aksidentet rrugore.

Shërbimi online është kthyer në kryefjalën e kohëve që po jetojmë, ndaj dhe ne si SIGAL UNIQA i kemi kushtuar rëndësinë e duhur, duke rritur dhe përmirësuar shërbimin online, qoftë sa i përket dhënies së informacionit klientëve në kohë reale, po ashtu edhe me shitjen e siguracioneve online.

Krahas rrjeteve sociale, të cilat janë kthyer në një urë shumë të thjeshtë dhe të shpejtë komunikimi me klientët, SIGAL UNIQA ka vendosur numra të dedikuar 24 orë çdo ditë të javës për komunikimin me Whatsapp dhe telefonata me klientët.

## FRYMËZUJMË

Ne i mundësojmë dhe ndihmojmë klientët tanë që të jetojnë një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë sepse ne jemi të interesuar tek njerëzit.

## FORMËSOJMË TË ARDHMEN

Ne jemi novatorë pararojë në industrinë e sigurimeve dhe vazhdojmë të zhvillohemi duke adresuar në kohë rekord të gjitha ndryshimet e shpejta teknologjike, qytetare, demografike dhe ato sociale.

## JEMI TË DREJTPËRDREJT

Ne jemi të saktë, të shpejtë, të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë.

## INVESTUJMË

Ne vazhdojmë të përmirësojmë strategjinë tonë të investimeve veçanërisht investimet e qëndrueshme që marrin në konsideratë objektivat e modelit "Njerëzit, Planeti dhe Përfitimi".



# AKTIVITETI I SIGAL UNIQA NË NIVELET E KËRKESAVE TË RREGULLATORIT AUSTRIAK DHE TË LIGJEVE TË BE-SË

SIGAL UNIQA ia ka arritur shumë mirë të jetë pasqyrë e standarteve të një tregu kërkues dhe të sofistikuar siç është ai i BE-së, nëpërmjet një sistemi shumë praktik dhe eficient bashkëpunimi të vazhdueshëm me UNIQA-n.

Një histori e gjatë suksesi e një kompanie, siç është ajo e SIGAL UNIQA përgjatë 22 viteve, kalon pa dyshim edhe përmes ngritjes dhe koordinimit të infrastrukturës përkatëse organizative dhe normative, mbi të cilat kompania ushtron aktivitetin, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi, me gjithë ndryshimet dhe dinamikat e tij, por dhe duke ruajtur, natyrisht, fokusin primar të saj: shpërbimin e klientëve për besimin që ata kanë investuar tek kompania, në mënyrë sa më të drejtë, të thjeshtë dhe të shpejtë.

Është pa dyshim një motiv krenarie dhe stimul i jashtëzakonshëm të jesh, prej disa vitesh tashmë, në rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të Grupit SIGAL UNIQA dhe të kontribuosh sadopak, në këtë cilësi, në përmbushjen e angazhimit për arritjen dhe mbajtjen e standarteve më të larta të shërbimit ndaj klientëve, me gjithë kërkesat apo sfidat organizative, ligjore apo rregullatore që Grupi SIGAL UNIQA duhet të përmbushë, nga njëra anë si shprehje e kërkesave dhe standarteve të aksionarit tonë kryesor UNIQA Insurance Group, dhe nga ana tjetër, duke përcjellë, përshtatur dhe implementuar këto kërkesa dhe standarte në tre vendet ku shtrihet Grupi SIGAL UNIQA, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

SIGAL UNIQA Group ia ka arritur shumë mirë të jetë pasqyrë e standarteve të një tregu kërkues dhe të sofistikuar siç është ai i BE-së, nëpërmjet një sistemi shumë praktik dhe eficient bashkëpunimi të vazhdueshëm me UNIQA, ku çdo dokument me natyrë normative me rëndësi dhe impakt të veçantë në aktivitetin e përditshëm të kompanisë që UNIQA nxjerr, implementohet dhe përshtatet dhe në të gjitha kompanitë e Grupit SIGAL UNIQA, duke bërë kështu që shpesh, këto kompani sigurimi të jenë në pararojë të zhvillimeve ligjore apo teknologjike të vendeve respektive ku ushtrjnë veprimtarinë.

Ka rreth pothuajse 6 vjet që në kompanitë e Grupit SIGAL UNIQA, me kërkesë të UNIQA-s është ngritur funksioni



ABDYL SARJA  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Compliance ose Përpueshmërisë, kërkesë e drejtpërdrejtë kjo e Direktivës 2009/138/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 25 nëntor 2009, që synon të risë vigjilencën e kompanive të sigurimit në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ndaj konsumatorëve, dhe ku çdo punonjës i nënshtrohet një sjelljeje shembullore jo vetëm për produktet dhe procedurat e tyre, por edhe në marrëdhëniet e tyre me palët e treta, funksion ky që ka filluar të implementohet së fundmi dhe në subjektet e tjera tregtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Po ashtu janë mesatarisht 12 Politika që rregullojnë aspektet kryesore të një kompanie sigurimi që UNIQA nxjerr apo përditëson çdo vit, dhe që po ashtu implementohen dhe përshtaten nga kompanitë e Grupit SIGAL UNIQA, duke ngritur kështu nivelin e aktivitetit të shoqërisë në nivelet e kërkesave të një Rregullatori Austriak, dhe të ligjit të BE, të gjitha këto, me qëllimin final të dhënies klientit/zyrtarit të rëndësisë që ai ka për shoqërinë dhe ndjesisë që Grupi SIGAL UNIQA meriton besimin e tyre.

Tek Grupi SIGAL UNIQA është ngritur sistemi Whistleblowing edhe ky një risi, nëpërmjet të cilit çdo kush mund të denoncojë një sjellje të pahijshme, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe duke ruajtur anonimat të plotë, standard edhe ky që rrit nivelin e përgjegjshmërisë së SIGAL UNIQA ndaj konsumatorit.

Nuk mund të lihet pa përmendur dhe

mbështetja e UNIQA-s dhe në drejtim të risive teknologjike ku Grupi SIGAL është po ashtu ndër të parat kompani që ka aplikuar shitjen on-line për një sërë produktesh, duke qëndruar kështu në një ritëm me rolin që po merr gjithmonë e më shumë dixhitalizimi apo Teknologjia e Informacionit në shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve për gjithë shoqërinë si e tillë.

Vitin e kaluar, për herë të parë në Shqipëri, në SIGAL UNIQA u krye një kontroll i përbashkët i dy institucioneve Rregullatore Shqipërisë dhe Austrisë, respektivisht AMF dhe FMA, me në fokus pikërisht zbatimin e Politikave dhe standarteve që vetë UNIQA detyrohet të përmbushë, kontroll që u finalizua me shumë rekomandime të vlefshme për të përmirësuar shërbimet tona.

Por transformimi dhe vizioni i UNIQA-s që përfshin dhe Grupin SIGAL UNIQA, ka projektin mjaft ambicioz UNIQA 3.0 për periudhën 2021-2030, që është pikërisht shprehje e ideve më inovatore dhe largpamëse në lidhje me strukturën organizative dhe të burimeve njerëzore të SIGAL UNIQA, ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve në kohët e sotme dhe mbështetjes sa më bindshme e në mënyrë të thjeshtë tek konsumatori.

Grupi SIGAL UNIQA do përcjellë me po aq bindje dhe siguri këtë vizion tek konsumatorët tanë dhe do të kem me kënaqësi përgjegjësinë dhe stimulim për të lehtësuar dhe dhënë jetë atij në kompanitë tona në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.



## Bordi Drejtues i Grupit SIGAL UNIQA

(Nga e majta në të djathtë) Saimir Dharmo (CEO i SIGAL UNIQA Group Austria Kosova), Alma Totokoçi (Zv. Drejtore e Përgjithshme e SIGAL UNIQA Group Austria), Avni Ponari (CEO i Grupit SIGAL UNIQA Group Austria), Edvin Hoxhaj (Drejtore i Përgjithshëm i SIGAL Life UNIQA Group Austria), Driton Azizi (Drejtore i Përgjithshëm i UNIQA Maqedoni e Veriut) dhe Elvis Ponari (Administrator i Përgjithshëm i Fondi të Pensioneve Vullnetare SIGAL Life UNIQA Group Austria)

# Misioni ynë

Një kompani shqiptare me standarte europiane si SIGAL UNIQA Group Austria e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 22 viteve punë, SIGAL UNIQA si grup ka paguar më shumë se 300 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj.

Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA ka paguar mbi 12 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL UNIQA ka dëshmuar përkujdesje maksimale për komunitetin, duke kontribuar në shëndet, art,

kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro ndër vite. Vepra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL UNIQA.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet ti japë mbrapsh komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo koqenë motoja jonë si SIGAL UNIQA që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen. Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krah për krah me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.



# PENSIONI VULLNETAR, INVESTIMI MË I MIRË PËR VETEN

Si Administrator i Përgjithshëm i fondit më të madh të pensionit vullnetar në Shqipëri, unë jam bërë një admirues i madh i aksionarëve tanë, SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA dhe Z. Avni Ponari. Anëtarët e bordit të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit "SIGAL" kanë marrë përsipër përgjegjësinë e madhe të qeverisjes dhe administrimit të investimeve të kontributeve në emër të përfituesve aktualë dhe atyre të ardhshëm.

Shoqëria Administruese prej 10 vitesh administron tashmë rreth 13 milionë euro dhe ju shërben 9.000 anëtarëve dhe 80 kompanive vendase, duke zotëruar 45% të tregut, me Fondin e Pensionit Vullnetar "SIGAL", e cila është një risi perëndimore prezantuar dhe aprovuar në Shqipëri për herë të parë në vitin 2006. Me një themel të fortë ligjor dhe kapitalin e duhur, Shoqëria Administruese e Fondit "SIGAL" krijoi mundësinë dhe një vlerë të shtuar për të gjithë, për ruajtjen e standardit të jetesës në moshën e pensionit.

Ne besojmë tek fuqia e bashkëpunimit dhe me këtë rast kemi kënaqësinë t'ju informojmë për Misionin dhe Vizionin e Fondit "SIGAL".

Ne punojmë me përgjegjësi sociale, për një biznes që rritet vazhdimisht dhe kontribuon për një jetë më cilësore për punonjësit, partnerët dhe komunitetin. Qëllimi ynë është t'i sigurojmë anëtarëve të Fondit SIGAL mundësinë e një pensioni të përshtatshëm për të ruajtur standardin e jetesës sipas kërkesave dhe nevojave të tyre, duke maksimizuar përfitimet nëpërmjet një administrimi të kujdesshëm të aseteve.

Me Vizionin për një kompani të njohur në mbarë rajonin dhe fokus për të mbajtur pozicionin lider në tregun e Pensioneve, përmes qëndrueshmërisë të lartë financiare, shërbimit cilësor, profesional dhe transparent për të gjithë anëtarët tanë.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL" përfaqësohet nga një staf i dedikuar dhe i specializuar pas së cilës qëndron kompania lider dhe më prestigjioze ndërkombëtare UNIQA GROUP AUSTRIA. Punën dhe suksesin në këtë Mision ne e ndërthurim bazuar në vlera thelbësore që mishërojnë jo vetëm atë që ne demonstrojmë në çdo përpjekje, por gjithashtu përfshijnë kulturën e kompanisë. Secili nga ne, në



Elvis PONARI, MBA, Msc  
Administrator i Përgjithshëm  
Fondi i Pensioneve Vullnetare  
SIGAL Life UNIQA

Fondin "SIGAL" ka parasysh disa vlera të veçanta si:

- Liderhip
- Integritet
- Angazhim
- Përsosmëri
- Puna në grup

Me një angazhim maksimal në të gjitha nivelet organizative, ne jemi shoqëria lider dhe më e besuar në fushën e administrimit të aseteve në tregun e pensioneve vullnetare. Ne ofrojmë shërbimin tonë me transparencë dhe standarde të larta, menaxhojmë asetet tuaja në mënyrë sa më eficiente, veprojmë me profesionalizëm dhe zbatojmë praktikën më të mira të investimit dhe menaxhimit të fondit me shërbim cilësor.

Anëtarët tanë na kanë besuar menaxhimin e kursimeve të tyre prej rreth 15 vitesh. Përfitimet financiare dhe favorizimet fiskale të pensionit vullnetar janë të shumta si:

- Kontributet e depozituara nga punëmarrësi në Fondin e Pensionit Vullnetar "SIGAL" zbriten nga të ardhurat personale për efekt tatimi mbi të ardhurat;
- Fitimi i realizuar nga investimi i aseteve të fondit nuk i nënshtrohet tatimit;
- Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve në Fondin e Pensionit Vullnetar "SIGAL" vlerësohet si shpenzim i zbritshëm për qëllim tatim mbi fitimin;
- Shërbimet e ofruara nga banka për Shoqërinë Administruese dhe anëtarët

e saj, konsiderohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Sistemi i pensioneve vullnetare është krijuar i tillë për t'ju ofruar një pension më të lartë dhe të ruani standardin e jetesës si tani. A e dini se pensioni shtetëror sipas studimeve të fundit është shumë i ulët dhe në të ardhmen mundet të mos arrijë të përmbushë nivelin e minimumit jetik? Prandaj, ky sistem është shumë më tepër i zhvilluar në perëndim dhe ne kemi qëllimin të arrijmë këtë edhe në Shqipëri. Në Fondin "SIGAL", paratë e investuara trashëgohe nga pasardhësit, ndryshe nga pensioni shtetëror ku me humbjen e jetës së pensionistit, ai pushon së ekzistuari. Paratë e investuara në fond mund të tërhiqen kur të doni dhe mund të investohen sipas mundësisë tuaj. Së fundmi, duke qenë pjesë e SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, ne kemi krijuar mundësinë që anëtarët tanë të përfitojnë bonuse nga paketa të tjera sigurimi (shëndetin, shtëpinë, makinën) që i ofron kompania mëmë.

Jemi të vetëdijshëm për sfidat që na presin në një kohë ku zhvillimi social dhe teknologjia ndryshon me ritme shumë të shpejta. Ne jemi të motivuar dhe të përgatitur për t'i arritur të gjitha objektivat tona, duke ju shërbyer me standardet e një kompanie lider dhe duke sjellë eksperiencat me të mira të vendeve evropiane.

Duke shpresuar që jemi emri që ju i besoni të ardhmen tuaj dhe t'ju kemi frymëzuar të bëheni pjesë e rrugëtimit tonë.



80 SUBJEKTE

9000 ANËTARË

13 MILION EURO NË ADMINISTRIM

45% TË TREGUT TË PENSIONEVE PRIVATE



# PRODUKTE TË REJA

**Si kompani pararojë e novacionit dhe produkteve të reja SIGAL UNIQA ishte e para kompani në Shqipëri që futi në treg produktet e sigurimit të shëndetit në vitin 2007 si dhe themeloi të parin Fond Privat Pensionesh, për t'ju dhënë një mundësi më tepër shqiptarëve për të patur një pension të dytë vullnetar në pleqëri.**



## COVID 19

Në betejën e vështirë kundër COVID 19, SIGAL UNIQA dëshmoi edhe një herë që është kompani jo vetëm pararojë e inovacionit duke ideuar dhe hedhur në treg produkte novatore sipas kërkesës dhe nevojës së klientëve por edhe mbështetësja më e madhe e klientëve dhe qytetarëve.

Për t'ju gjendur pranë financiarisht, SIGAL UNIQA, ishte e vetmja kompani që ideoi dhe ofroi klientëve sigurimin Anti-Covid, i cili mbulon shpenzimet për medikamentet, shpenzimet për tamponin dhe shpërbim ditor fiks në rast shtrimi në spital. Qëllimi i këtij sigurimi nuk është që të rezultojë me fitim për kompaninë, por të ndihmojë qytetarët e prekur nga virusi COVID 19, të cilët nuk kanë mundësi të përballojnë kostot financiare të sëmundjes.



## TELEFONO NJE MJEK

Është ky një tjetër shërbim novator i SIGAL UNIQA për klientët, i cili mori një zhvillim të madh gjatë kohës së pandemisë.

Telefoni një Mjek, është një shërbim mjekësor online, nëpërmjet të cilit, klientët marrin këshilla mjekësore në çdo orë të ditës apo natës, nga një staf mjekësor i specializuar dhe me eksperiencë.

Nëpërmjet këtij shërbimi, i cili ofrohet nëpërmjet një aplikacioni që instalohet në celularin e çdo klienti, jepet asistencë mjekësore për çdo ankesë apo nevojë që ka secili, madje mund edhe të merren receta online për probleme të ndryshme shëndetësore.

Nuk ka rëndësi se ku ndodhni, mjafton të keni një celular dhe internet dhe mund të komunikoni me mjekun me telefonatë ose video dhe të këshilloheni për problemin tuaj.

Në grupin e mjekëve të këtij shërbimit që ofrohet nga SIGAL UNIQA, ka edhe mjekë peditër, që do të thotë ju mund të merrni këshilla mjekësore edhe për fëmijët tuaj, nëse e keni blerë këtë shërbim për të gjithë familjen.



## APLIKACIONI SIGAL UNIQA GPS

Tashmë klientët e SIGAL UNIQA, të cilët kanë blerë shërbimin SIGAL GPS, mund ta kontrollojnë automjetin e tyre nga telefoni, shumë thjeshtë dhe shpejt, nëpërmjet aplikacionit më të ri SIGAL UNIQA GPS, i cili mund të shkarkohet nga playstore. Shërbimi GPS i ofruar nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA u mundëson klientë të shikojnë në çdo moment se ku ndodhet mjeti i tyre, rrugën e përshkruar, shpejtësinë e lëvizjes së mjetit etj.

- Përcaktimi i vendndodhjes së automjetit,

Mjeti/mjetet monitorohen në kohe reale duke përcaktuar edhe shpejtësinë e lëvizjes së tyre

## Kërkimi i MJETIT

Që nga momenti i vendosjes së GPS në mjetin tuaj, në çdo kohë do të keni informacion për:

1. Itinerarin ditor te lëvizjes se mjetit.
2. Rruga e përshkruar (route) nga mjeti gjatë cdo intervali kohor.
3. Përlogaritje e sasisë së karburantit të konsumuar për cdo lëvizje.
4. Kohën e qëndrimit ndezur apo fikur.
5. Idle time (koha e qëndrimit ndezur të mjetit pa lëvizur).
6. Kilometrat e përshkruar për cdo ndezje-fikje të mjetit, për një ditë, javë, muaj apo për çdo interval që ju dëshironi.
7. Shpejtësitë e lëvizjes së tij.
8. Geofencing (zonat e lejuara për lëvizjet e mjeteve).



## SIGURIMI "JETË PLUS"

1 në 5 persona diagnostikohen çdo ditë me sëmundje kritike përpara se të arrijnë moshën 65 vjeç. Në Shqipëri, 60% e vdekjeve vijnë si pasojë e sëmundjeve të zemrës, ku 40% janë me shkaktar sëmundjet koronare.

Në kohë të tilla, duhet të luftojmë me sëmundjen dhe jo të shqetësohemi ku dhe si ti gjejmë paratë. Prandaj është e rëndësishme që të kesh një partner të sigurtë dhe të fuqishëm financiar, për përballuar të gjitha shpenzimet në rast nevojë.

SIGAL UNIQA Group Austria ka ideuar një produkt të ri sigurimi, "Jetë Plus", i cili ju mundëson të merrni shërbimet mjekësore në spitalet më të mira në botë për sëmundjet serioze.

Me mbulim deri në 1 milion euro në vit ose 2 milionë euro gjatë gjithë jetës, sigurimi "Jetë Plus" ju mbulon shpenzimet për diagnostikimin, konfirmimin e diagnozës dhe trajtimin në spitalet që zgjedh vetë pacienti.

Primi për këtë sigurim është 31,000 lekë për personat e rritur dhe 20,000 lekë/person për të miturit.

Sëmundjet që mbulohen nga sigurimi "Jetë Plus" janë:

- Tumoret Malinje (kancer)
- Ndërhyrjet kirurgjikale në zemër
- Ndërhyrjet kirurgjikale në kokë
- Ndërhyrjet kirurgjikale në kokë
- Transplantet nga një dhurues i gjallë



## SIGURIMI "SHËNDET NË UDHËTIM" ME ANULLIM

SIGAL UNIQA ofron për herë të parë Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim me opsionin shtesë për anulimin e udhëtimit.

Me këtë sigurim shtesë, SIGAL UNIQA, do t'ju mbulojë financiarisht nëse ju do të jeni të detyruar që ta anuloni udhëtimin tuaj për SHKAQË TË PAPRITURA dhe TË PAPARASHIKUARA përtej kontrollit tuaj.

Çfarë mbulohet nga opsioni i Anullimit të Udhëtimit?

Rimbursimi i biletës së udhëtimit nga:

- Çdo dëmtim serioz ose gjendje të paparashikuar mjekësore që jua bën juve ose bashkëudhëtarit tuaj të pamundur udhëtimin;
- Në rast fatkeqësie për ju apo një familjar tuajin;

Një detyrim ligjor siç mund të jetë thirrja në gjykatë si dëshmitar.



## SIGURIMI I SHËNDETIT DHE ANTI COVID 19 PËR NXËNËS DHE STUDENTË

SIGAL UNIQA ka hedhur në treg produktin e ri për nxënësit dhe studentët, Sigurimin e Shëndetit&Anti Covid 19, i cili mund të blihet edhe online, përveçse në të gjitha zyrat e SIGAL UNIQA në të gjithë Shqipërinë.

## ÇFARË MBULON?

- Deri në 100,000 lekë/vit shpenzime spitalore
- Deri në 120,000 lekë/vit në rast mjekimi në shtëpi për COVID-19
- Deri në 1,000,000 lekë për sigurimin e jetës së prindit

## SA KUSHTON?

10,000 lekë/vit  
Sigurimi Anti COVID ofrohet edhe për studentët shqiptarë që do të shkojnë të studiojnë jashtë.



# INOVACION

## E ARDHMJA ËSHTË ONLINE

### BLERJE ONLINE E SIGURACIONEVE

Të vetëdijshëm për ndryshimet që dikton koha, ne si SIGAL UNIQA i kemi paraprirë ndryshimeve duke investuar dhe zhvilluar teknologjinë.

SIGAL UNIQA ishte e para kompani në Shqipëri e cila realizoi blerjen online të siguracioneve nga celullari ose kompjuteri, nga kudo ku klientët ndodhen.

Aktualisht në faqen zyrtare të SIGAL UNIQA ([www.sigal.com.al](http://www.sigal.com.al)) numërohen mbi 10 produkte sigurimi që mund të blihen online dhe po punohet që të gjitha produktet (SIGAL UNIQA numëron mbi 43 produkte sigurimi) të shiten edhe online.

Krahas blerjes së siguracioneve online, klientët e SIGAL UNIQA, mund të marrin në faqen zyrtare

online si dhe në aplikacionin mobile të gjitha informacionet që iu nevojiten mbi sigurimet si dhe të hapin praktikatat për dëmshpërblim në rast aksidenti apo dëmi shëndetësor.

Produktet që mund të porositen ose blihen online nga SIGAL UNIQA:

- Sigurimi COVID 19
- Sigurim TPL
- Kartoni Jeshil
- Polica Kufitare
- Sigurimi i Pronës
- Sigurimi i Jahteve
- Shëndet në Udhëtim
- Shëndet në Udhëtim me Anullim
- Shëndet në Udhëtim për të Huajt
- Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve
- Sigurimi i Studentëve jashtë Shqipërisë
- Sigurimet e Shëndetit (rreth 10 karta shëndeti)

### MUZEU I SIGURIMEVE SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA është e vetmja kompani në Shqipëri dhe rajon, e cila e ka dokumentuar të gjithë historikun e saj, që prej themelimit më 1999 e deri në ditët e sotme, përmes një muzeu sigurimesh.

I vendosur në zyrat qendrore të SIGAL UNIQA, muzeu mbart pjesë nga ngjarjet, objektet dhe historia e dhjetëra viteve punë të drejtuesve dhe stafit të SIGAL UNIQA, sikundër është një dëshmi për zhvillimin e tregut privat të sigurimeve në Shqipëri.

Së shpejti, pritet që muzeu të dixhitalizohet dhe ti ofrohet mundësia publikut që ta shohë edhe nëpërmjet telefonit.



### AUDIOBOOKS.AL

Për herë të parë në Shqipëri, SIGAL UNIQA, ka realizuar projektin e librit audio, i cili iu ofron të gjithë qytetarëve, librat më të mirë të të gjitha kohërave në audio, krejtësisht falas. Synimi i SIGAL Audiobooks.al është që të sjellë shqiptarët më afër librit, përmes një metode të re, dhe të nxisë edukimin e qytetarëve shqiptarë dhe shqipfolës, brenda dhe jashtë kufijve.

Projekti i parë dhe i vetëm në Shqipëri, i cili sjell në versionin audio librat e autorëve më të mirë shqiptarë dhe të huaj, të lexuar nga zërat emblematicë shqiptarë, është ideuar nga Avni Ponari, biznesmen dhe filantrop i njohur dhe Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group Austria.


SIGAL Audiobooks.al është një librari audio krejtësisht falas për të gjithë shqiptarët anembanë globit dhe është i aksesueshëm 24 çdo ditë të javës. Sigal Audiobooks.al numëron deri më tani mbi 50 mijë përdoruesë nga Shqipëria dhe nga Bota, kudo ku ka shqiptarë dhe pasurohet çdo ditë me libra dhe autorë të rinj për të rritur dhe fëmijë.

Kushdo që dëshiron ta ketë në telefonin e tij, mund të shkarkojë aplikacionin SIGAL Audiobooks.al në appstore ose playstore dhe mund ta ketë librarinë virtuale gjithmonë me vete.

### SHQIPËRIA LIVE

Për ti sjellë edhe më pranë Shqipërisë bashkëkombasit tanë anembanë globit, realizuam të parën dhe të vetmen platformë unike SHQIPËRIA LIVE ku mund të ndiqen 24 orë të gjitha qytetet e Shqipërisë në kohë reale.

Krahas pamjeve live nga qytetet e Shqipërisë, kushdo që futet në kanalën e youtube Shqipëria Live, mund të marrë edhe informacione mbi ngjarjet e fundit që ndodhin në Shqipëri, informacione mbi hotelierinë dhe turizmin dhe sigurisht edhe mbi tregun e sigurimeve.





# PËRGJEGJËSIA SOCIALE

## NË NDIHMË TË KOMUNITETIT - SPORT - ART - KULTURË - TRASHËGIMI KULTURORE

Që prej vitit 1999 renditemi si kompania më e madhe dhe më e besuar në vend dhe rajon dhe kjo falë besimit të mijëra klientëve tanë. Përveç përgjegjësisë kontraktuale ndaj klientëve, ne kemi dëshmuar se i kushtojmë një vëmendje të veçantë komunitetit, artit, kulturës dhe sportit në vend, duke u dhënë atyre mbështetjen e nevojshme dhe vëmendjen e duhur.

Krahas punës së përditshme, ku mbi 1600 punonjës të kualifikuar të SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut u shërbejnë mbi 1 milion klientëve, kemi kontribuar vazhdimisht për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, kemi promovuar Shqipërinë; kemi kontribuar në art, kulturë, trashëgimi kombëtare, në sport, tek talentet shqiptare dhe në qindra aktivitete sociale në çdo cep të Shqipërisë si dhe jashtë kufijve.







## ARTI & KULTURA

Jemi e para dhe e vetmja kompani në Shqipëri që themeloi një klub arti, i cili u shërben mijëra artistëve në të gjithë vendin. **Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL**, që ndodhet në qytetin e Durrësit, është i vetmi në llojin e tij dhe çdo vit mirëpret me qindra artistë të rinj dhe të afirmuar, duke u shndërruar kështu në një vatër kulturore për Shqiptarët.

**Orkestra e Harqeve e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA** që nga themelimi i saj në 2013 ka dhënë me dhjetëra shfaqje artistike në shumë qytete të Shqipërisë dhe është vlerësuar me çmime të rëndësishme për performancën e saj, ku mund të përmendim çmimin e parë të edicionit të pestë të Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve dhe Muzikës së Dhomës si dhe Çmimi Ndërkombëtar



"Xhoja", një nga më të rëndësishmit në fushën e artit.

### Ekspozita UNIQA'ART

Me rastin e 20-vjetorit të themelimit të saj, SIGAL



UNIQA çeli të parën ekspozitë sigurimesh në Shqipëri, me karikatura të punuara enkas për

kompaninë SIGAL, nga mjeshtri i karikaturave, Bujar Kapexhiu.


Ekspozita u çel në ambientet e Muzeut Kombëtar për disa ditë me radhë dhe u vizitua nga qindra qytetarë, biznesmenë, njerëz të artit dhe kulturës si dhe nga personalitete të ambasadave dhe politikës në vend.

Për të mbështetur vlerat historike dhe kulturore të Shqipërisë, kemi mbështetur prej vitesh Festivalin Mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës "Argjiro Fest-On"; Festivalin Ndërkombëtar Operistik Marie Kraja, i cili sjell në Shqipëri emra të njohur të artit ndërkombëtar.

Takimi Muzikor i Dy Botëve, i cili bashkon artistët e huaj dhe ata Shqiptarë në vendin tonë, Kënga Magjike përgjatë viteve, Vienna Salutes Tirana zhvilluar në Austri dhe Tiranë, Different Trains Festival, koncertin e artistit të njohur ndërkombëtar Shkëlzen Doli, mbrëmjen artistike "Nata Vjenezë" me solistin e Teatrit Vjenez te Operas dhe Baletit Eno Peçi, janë të tjera evente artistike të mbështetura nga SIGAL UNIQA Group Austria.

Çmimi 'Yjet e Operas Shqiptare'; Çmimet e Akademisë Kult; Koncerti 'Tre Tenorët' si dhe ekspozita të ndryshme në Galerinë e Arteve të Bukura, janë mundësuar falë mbështetjes tonë.

Vlerësojmë letërsinë duke kontribuar në botimin e



librave si: 'Reshat Arbana-Nderi i Kombit', At Zef Pllumit 'Rrno për me tregue', librin e 70-vjetorit të krijimit të Federatës Shqiptare të Basketbollit, Librin për Detarinë Shqiptare etj.

Ekspozitën e artistit austriak Peter Kogler; Instalacionin 'Reja' të muzeut britanik të arteve i instaluar në Tiranë pranë Galerisë Kombëtare të Arteve', 100 veprat më të mira të artit Romak të ekspozuara në Galerinë e Arteve, Ekspozitën e rrallë në Bajram Curri "Shqipëria e viteve '90" e realizuar nga antropologu dhe fotografi i mirënjohur austriak Robert Pichler, janë të tjera evente të realizuara falë kontributit të SIGAL UNIQA.

## TRASHËGIMIA KULTURORE



Duke vlerësuar maksimalisht trashëgiminë tonë kulturore, kemi rindërtuar ndërtesat karakteristike në Berat,

Korçë dhe Pogradec, duke u rikthyer këtyre qyteteve disa prej pasurive më të mëdha arkitekturore.

Kinema Millenium në Korçë, pas djegies totale, u rikthye në gjendjen e mëparshme nga SIGAL.

Teatri SKAMPA, një prej tempujve kulturorë të vendit, pas djegies totale u rindërtua nga SIGAL UNIQA dhe iu rikthye qytetarëve të Elbasanit.



## PROMOVOJMË SHËNDETIT



Me qëllim promovimin e shëndetit të mirë, SIGAL UNIQA ndërtoi të parën dhe të vetmen Klinikë Lëvizëse Shëndetësore në rajon, e cila që prej 2015-ës ka ofruar ekzaminime shëndetësore falas për qindra banorë në çdo cep të Shqipërisë, që nga Valbona, Thethi, Lëpusha, Bajram Curri, Shkodra, Lezha, Korça, Pogradeci, Elbasani, Tirana, Berati,

Vlora, Saranda, Konispoli etj.



Si shërbim shtesë për kujdesin shëndetësor, kemi hapur Klubin e Shëndetit VitalClub, në të cilin marrin trajtime fizioterapeutike qindra klientë të SIGAL UNIQA.

## PROMOVOJMË SHQIPËRINË



Në 100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me UNIQA Group dhe Muzeun e Vjenës, sollëm në Shqipëri koleksionin e plotë të Armëve të Skënderbeut me vlerë 35 milionë euro.

Me qëllim promovimin e Shqipërisë tek të huajt, kemi ftuar vazhdimisht përfaqësuesë biznesesh, diplomatë, gazetarë, drejtuesë bordesh dhe veprimtarë të ndryshëm, duke organizuar jo vetëm konferenca dhe takime biznesi, por edhe ture turistike nga veriu në jug të Shqipërisë.





Për këtë qëllim, u zhvillua në Shqipëri Konferenca Rajonale e Drejtuesve të lartë të kompanive UNIQA nga 19 shtete europiane; Me ftesën tonë, një grup gazetarësh të njohur austriakë vizituan Shqipërinë dhe përcollën në vendin e tyre me dhjetëra artikuj, kronika, reportazhe dhe materiale të tjera promovuese për Shqipërinë; Klubi Rotarin Austriak, i përbërë nga investitorë të rëndësishëm austriakë, vizitoi Shqipërinë me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari.

Në vitin 2014 organizuam një guidë turistike në Valbonë, ku rreth 150 përfaqësuesë të institucioneve financiare shqiptare ishin mysafirë të banorëve të Valbonës.

## ARSIMI



Sporti bashkon zemrat dhe kombet dhe si të tillë e kemi vlerësuar çdo vit, duke kontribuar pothuaj në të gjitha disiplinat sportive.

Prej vitesh mbështesim Federatën Shqiptare të Basketbollit dhe jemi sponsor zyrtar të saj; Ringritëm klubin e basketbollit Valbona

Investimi tek arsimi dhe tek brezat e rinj ka qenë në vëmendjen e SIGAL UNIQA përgjatë gjithë këtyre viteve, duke kontribuar financiarisht në institucione të ndryshme arsimore.

Kemi mundësuar bursa studimi për shkollën Austriake në Shkodër, kemi dhuruar mjete mësimore për shkollën 9-vjeçare në Vermosh, realizuam rikonstrukcionin e shkollës Matosh Uka në Fierzë dhe e pajisëm këtë shkollë me laborator të ri mësimor, kemi realizuar praktika mësimore për universitete të ndryshme në vend e plot vepra të tjera për arsimin.

## SPORTI



dhe e shpallëm kampione; Prej më shumë se 15 vitesh mbështesim kampionen e basketbollit SIGAL Prishtinën, e cila edhe falë mbështetjes sonë është shpallur 12 herë kampione e Superligës dhe ka fituar 2 kupa Ballkanike;

Liga Ballkanike e Basketbollit u riemërua SIGAL UNIQA Ballkan League falë bashkëpunimit disa-vjeçar me SIGAL UNIQA; Kemi ndërtuar fusha basketbolli për të rinjtë në Tiranë dhe kemi kontribuar në zhvillimin e basketbollit në të gjithë vendin.

Jemi sponsor zyrtar të Federatës Shqiptare të Futbollit;

Kemi mbështetur alpinizmin për disa vite dhe alpinistë profesionistë; Në atletikë talentët Izmir Smajlaj dhe Luiza Gega janë mbështetur financiarisht nga SIGAL UNIQA; Aeronautika shqiptare me aktivitetin "Albania Open"; Motor Fest, rally albania; garat me motorë Vespa; Regatën Lundrimore për fëmijët e fshtatit SOS; Kampionatin e volëjbollit; Kampionatin e parë ndërkombëtar të Shahut; kampionatin e çiklizimit; konkursin e dancit sportiv; kullat e vrojtimit në zonat turistike, biçikletat për policinë e patrullimit në plazhet shqiptare, të gjitha këto kanë patur mbështetjen e SIGAL UNIQA Group Austria përgjatë viteve.



## VLERËSIME PËR SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Vit pas viti SIGAL UNIQA Group Austria është vlerësuar maksimalisht nga institucione prestigjioze financiare në Europë dhe Botë, sikundër edhe nga institucionet shqiptare.

E vlerësuar vazhdimisht për shërbimin cilësor ndaj klientëve, lidhshimin, risitë dhe prestigjin si dhe performancën në treg, SIGAL UNIQA rendit me dhjetëra çmime, nominime dhe certifikata.

"European Awards for best Practices"  
 "Best Insurance Company-Southeast Europe"  
 "The Winner Awards Trophy"  
 "Best Enterprise"  
 "Best Insurance Company Albania"  
 "Best Buy Award"  
 "TOP 100 Insurance Companies in CEE"  
 "Golden Europe Award for Quality & Commercial Prestige"  
 "Best insurance company for the best quality in the market"  
 "Superbrand of Albania"  
 "Biznesi më i mirë i viti 2018" nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë  
 "TOP 200 kompanitë më të mëdha" për vite me radhë nga revista Monitor  
 "Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri"  
 "Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për vitin 2020"  
 "Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për nga fuqia e aseteve për vitin 2020"  
 "Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për fuqinë e kapitalit për vitin 2020"  
 "Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për primet neto për vitin 2020"

## SIGAL UNIQA shpallet fituese e Çmimit të Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar

Më 7 shkurt 2020, Partnerët Shqiptarë për Ndryshim dhe Zhvillim kanë vlerësuar filantropinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA duke i akorduar Çmimin e Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar me motivacionin: "Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve"

## VLERËSIME PËR DREJTUESIN E SIGAL UNIQA, AVNI PONARI

Krahas vlerësimeve të shumta që SIGAL UNIQA ka marrë ndër vite, një vlerësim të madh i është dhënë themeluesit dhe drejtuesit të kompanisë,





Avni Ponari, të cilit i janë akorduar me dhjetëra çmime, tituj e certifikata ndër vite.

#### Avni PONARI, “CEO më Revolucionar për vitin 2020”

Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA nderohet nga revista prestigjioze e biznesit ‘BUSINESS SIGHT MAGAZINE’ si një nga CEO-t më Revolucionar të Revistës për vitin 2020, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në botën e biznesit.

#### “The Order of the Rising Sun, Gold Rays Ëith Neck Ribbon”

Ambasada e Japonisë më 2020 e vlerësoi Avni Ponarin me titullin “The Order of the Rising Sun, Gold Rays Ëith Neck Ribbon” për kontributet e tij të jashtëzakonshme për promovimin e shkëmbimeve dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore mes dy vendeve, si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Tiranë përgjatë dhjetë viteve të fundit.

#### “Grand Decoration of Honour”

Presidenti i Austrisë e dekoroi Z. Ponari me titullin “Grand Decoration of Honour”, i pari vlerësim i këtij lloji që i akordohej një personaliteti shqiptar.

#### “Biznesmeni i Vitit 2019”

Avni Ponari u votua nga shqiptarët në gazetën Koha Jonë si “Biznesmeni i Vitit 2019”.

#### UET vlerëson Avni Ponarin me “Titullin e Mirënjohjes”

Dekanati i Universitetit European të Tiranës vlerësoi Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me TITULLIN E MIRËNJOHJES “Për rolin dhe kontributin e tij në zhvillimet ekonomike dhe sociale në vend, për angazhimin në përmirësimin e përhershëm të programeve të studimit të brezit të ri dhe asistimin e tyre me programet e intershipit dhe punëve kërkimore për të nxitur inovacionin në binzes, si edhe për edukimin mbi sigurimet dhe përfaqsimin ndaj shëndetit e sigurisë së jetës gjatë pandemisë COVID-19.

#### Avni PONARI një nga “20 CEO-t me performancën më të mirë për vitin 2020”

Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA nderohet nga REVISTA PRESTIGJOZE e Biznesit ‘INSIGHT SUCCESS MEDIA TECH’: “20 CEO-t ME PERFORMANCËN MË TË MIRË NË VITIN 2020”. Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në botën e biznesit nëpërmjet arritjeve, zhvillimit, pozicionimit të fuqishëm strategjik në treg dhe disiplinën operacionale dhe ekzekutive përgjatë dy dekadave.

#### Drejtuesi më i mirë i sigurimeve në Shqipëri dhe Europën Juglindore

Revista Finance Central Europe, vlerëson punën e shkëlqyer të themeluesit dhe drejtuesit të SIGAL UNIQA, Z. Avni PONARI, duke e vlerësuar si “DREJTUESI MË I MIRË I SIGURIMEVE NË SHQIPËRI DHE EUROPËN JUGLINDORE”. Drejtuesi më i mirë i sigurimeve në Shqipëri për vitin 2020; Drejtuesi më i mirë i sigurimeve në rajonin e Europës Juglindore për vitin 2020.



## COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE DHE EFEKTET NË EKONOMI



**Avni PONARI**  
CEO, SIGAL UNIQA Group Austria  
Shqipëri - Kosovë - Maqedoni e Veriut

Koronavirusi është një fatkeqësi e madhe botërore, e paparashikuar dhe e paprogramuar gjëkund, por në fund të fundit ne duhet të dalim edhe me disa konkluzione nga kjo betejë e hidhur, dhe me siguri këtë po bëjnë të gjitha shtetet. Përtej gjithë kësaj, pjesa tjetër më e rëndësishme për të cilën duhet të flasim është ekonomia. Çfarë po ndodh me sistemet ekonomike dhe kush po goditet më shumë nga kjo pandemi? A i kemi nxjerrë mësimet nga kjo pandemi që po vazhdon të gjunjëzojë mbarë botën?

Siç thotë edhe historiani i njohur, Yuval Harari, “Ne nuk mund të parandalojmë shfaqjen e sëmundjeve të reja infektive, por sidoqoftë ne kemi fuqinë të fenojmë këtë lloj sëmundje epidemike dhe ta parandalojmë atë të vrasë miliona njerëz”.

Kësaj unë do t'i shtoja edhe që ne kemi mundësinë që të parandalojmë shkatërrimin e ekonomisë.

Kjo pandemi ekspozoi brishtësinë e ekonomive tona, duke

paraqitur sfida madhore në zinxhirin e furnizimit dhe goditjen e bizneseve të tilla si bursa, linjat ajrore, udhëtimet, luhatjet e tregjeve financiare, sektorin ban kar dhe atë të sigurimeve dhe të të gjithë zinxhirit të shërbimeve në hoteleritizëm, bar-kafe dhe dyqane. Kështu, kjo pandemi nuk është thjesht një krizë mjekësore, por gjithashtu sociale dhe ekonomike.

Siç kuptohet, kjo pandemi nuk njeh kufij, po rrëzon të vegjël e të mëdhenj, të suksesshëm apo më pak të suksesshëm, të bardhë apo me ngjyrë, e gjithë bota sot është e gjunjëzuar para saj.

Në këtë situatë ku ndodhemi, pyetja që shtrohet është: kjo situatë e përbotshme apo edhe llojet e tjera të krizave dhe katastrofave që kemi kaluar apo që mund të vijnë në të ardhmen a kanë ndonjë mbrojtje?

Nevojat e mëdha kërkojnë zgjidhje të mëdha. Një vend i vogël është vështirë të mbrohet, por lehtë të qeveriset. Mjafton të kesh dëshirën dhe të vendosësh njerëzit në punë. Në botë ka me qindra kompani që kanë të punësuar aq sa është e gjithë popullsia e punësuar në Shqipëri.

Atëherë një skanim i mundshëm i të gjithë sektorëve mbi nevojat reale dhe më pas një vlerësim real, dhe jo vetëm kaq, por duke klasifikuar rreziqet e mundshme dhe mbrojtjet nga ana tjetër është i domosdoshëm.

Sigurimet në rrugë institucionale, skemat e garantimit dhe mbrojtjeve financiare për individin dhe kompanitë lindën

si nevojë e kohës. Falë kësaj garancie siguruese askush nuk do të dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme, sepse rreziku potencial është i mbuluar. Nga pikëpamja social-ekonomike, pandemitë janë njësoj si katastrofat natyrore vetëm se katastrofat janë lokale ndërsa pandemitë globale.

Në 500 vite, sipas dokumenteve shkencore, përlogaritet që bota të ketë kaluar 15 pandemi globale dhe mijëra katastrofa natyrore. Vetëm në Shqipëri, sipas raportit 2018, të FAO-s (Food and Agriculture Organization, të Kombeve të Bashkuara) në Shqipëri në 150 vitet e fundit kanë ndodhur 4000 katastrofa natyrore. Vetëm në 20 vitet e fundit, nga përmbajtjet e mëdha është shpallur tri herë gjendja e “Katastrofës Natyrore”. Përveç humbjes së jetëve njerëzore, ajo ç'ka këto pandemi kanë vrrarë më tepër ka qenë ekonomia.

Sipas disa vlerësimeve të studiuesve Melecky dhe Raddatz 2011, katastrofat natyrore kanë rritur shpenzimet e qeverisë me një mesatare prej 15 për qind dhe kanë ulur të ardhurat me rreth 10 për qind gjatë pesë viteve pas një katastrofe, duke çuar në një rritje të konsiderueshme të deficitit të përgjithshëm të buxhetit.

Tërmetet e vitit të kaluar vendosën në qendër të vëmendjes siguruesit, të cilët u përmbajtën nga kërkesat për kompensim dëmsh. Për të dy tërmetet janë dëmshpërblyer mbi 5000 qytetarë që kanë qenë të siguruar. Tregu i sigurimeve ka paguar miliona euro, duke përmbushur detyrimet ndaj klientëve dhe



duke treguar përgjegjshmëri për punën dhe misionin e tyre.

Po sa veta u dëmtuan nga tërmeti? Me mijëra. Sa përfituan? Shumë pak. Sepse duhet të ishim të gjithë të siguruar, për t'u mbrojtur financiarisht dhe që të ketë vijimësi normale të jetës.

Të bën përshtypje që ato dy tre ditë pas tërmetit pati ndonjë të siguruar, si duket nga frika e momentit, më pas toka u qetësua dhe njerëzit heshtën! Përsëri në dorë të Zotit! Situata është pothuajse e njëjtë tani. Nuk kemi tërmet, por kemi pandemi. A ka sigurim ndaj pandemisë? Patjetër që ka. Sot çdo ngjarje që ndodh në tokë është e sigurueshme. Nëse këto biznese që sot janë mbyllur përkohësisht do ishin të siguruar, atëherë gjithçka do ishte paguar. Pra, nëse një fason, hotel apo linjë ajrore do kishte marrë edhe këtë lloj sigurimi, përveç sigurimeve bazë, atëherë shoqëritë e sigurimit do bënin kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia.

Është shumë e domosdoshme që një kompani të sigurojë ndërprerjen e biznesit, sepse sigurimi krijon mundësinë që ta vijosh biznesin njësoj siç ka qenë më përpara. Sigurimi përfshin fitimin e munguar, pagat e punonjësve dhe këto janë të mirëpërcaktuara në kontratë, me një limit të përcaktuar në varësi të primit të paguar dhe reziqeve të mbuluara, në bazë të kapaciteteve dhe fuqisë financiare të kompanisë e cila kërkon të sigurohet.

Por pyetja që natyrshëm lind është: Sa kompani në Shqipëri e kanë një sigurim të tillë? Në hi storinë time 30-vjeçare me sigurimet, vetëm një kompani e huaj në Shqipëri pati siguruar çdo gjë, jetën e punonjësve, shëndetin e tyre, asetet e kompanisë dhe sigurimin e ndërprerjes së biznesit. Pra në 30 vite sigurime, vetëm një kompani

e ka patur këtë sigurim dhe kjo natyrisht që ishte kompani e huaj.

Ndërsa nëse i referohemi botës së zhvilluar, atje jo vetëm biznesi që ka absolutisht të siguruar çdo gjë, por edhe individët nuk mund të mendohet që të mos kenë të paktën 3 sigurime: jetën, shëndetin dhe pronën. Në Singapor për shembull, gjatë periudhës së pandemisë që po kalojmë, sistemi i serverave nuk arinte të mbante ngarkesën e madhe të aplikimeve nga kërkesat për sigurim jete, shëndeti, etj.

Dua të sjell një shembull nga Austria sa i përket sigurimit të biznesit. Një prej fabrikave më të mëdha të prodhimit të birrës atje, e cila e kishte provuar para 102 vitesh një pandemi të tillë, atë të Gripit Spanjoll, i cili mori 50 milionë jetë njerëzish, e bënte sigurimin e ndërprerjes së biznesit çdo vit, duke përfshirë edhe vitin e kësaj pandemie që ndodhemi. Dhe sot, pavarësisht se është ndërprerë biznesi i saj për shkak të COVID-19, ajo ka të mbuluar nga kompania e sigurimit edhe pagat e punonjësve, edhe fitimin e munguar dhe çdo gjë që ka të bëjë me biznesin e saj.

E pra, gjithçka është e mundur, por për ne është pak e vështirë ta kuptojmë dhe besojmë, por ja që ekzistojnë edhe këto sigurime edhe këto mbulime, sepse kjo industri i ka edhe ekspertizat dhe kapacitetet financiare.

Fatkeqësisht, industria e sigurimeve në Shqipëri është shoqëruar gjatë gjithë këtyre 30 viteve të ekzistencës së saj nga një lloj "pandemie", ku rritja për frymë e sigurimeve është vetëm 30 euro, pra me 1 euro në vit. Në të gjithë këtë peisazh ndikon trashëgimia jonë e një mentaliteti komunist, ku mendohet që është shteti ai që duhet të na nxjerrë nga çdo fatkeqësi dhe nuk e shohim si përgjegjësi individuale. Ose e kuptojmë këtë si një mbështetje për industrinë e


sigurimeve. Por në fakt nuk është kështu. Sigurimet dhe zgjerimi i tyre janë një mbështetje për qytetarët dhe rritje e personalitetit të tyre. Në vende ku nuk ka industri sigurimi të zhvilluar dhe ku individ është tërësisht i varur nga shteti, detyrimisht mungojnë dhe liritë e individit, në themel edhe demokracia. Sepse pavarësia e individit dhe liritë e tij fillojnë nga financa dhe rriten ngadalë së bashku me to.

Ajo që bota ka mësuar ndër vite e shekuj, është se nuk mund t'u shpëtosh dot pandemive dhe katastrofave natyrore. Ndaj, është e nevojshme që shteti të implementojë politika parandaluese si përgjigje ndaj katastrofave natyrore. Qeveria duhet të marrë në konsideratë përdorimin e metodave të hartuara nga ekspertë që kanë studiuar qasjet për parandalimin dhe përballimin e efekteve prej fatkeqësive natyrore, duke vendosur në rang kombëtar sigurimin ndaj katastrofave natyrore.

Si përfundim, duhet thyerje e konceptit se këto gjëra i rregullon qeveria dhe duhet kaluar në ekonominë reale të tregut, ku gjithkush është përgjegjës për çfarë ka krijuar. Pra, duhen reforma të thella që njerëzit të dinë ku të drejtohen në rast fatkeqësish. Ne kemi fatin që nuk mund të eksperimentojmë, por mjafton të përshtasim legjislacionin me vendet e Komunitetit Evropian, duke ulur rolin kujdestar të Qeverisë dhe duke rritur rolin e qytetarit, i cili është pjesë e ekonomisë së tregut.

Është e rëndësishme të themi se tregu i sigurimeve në Shqipëri është i risiguruar në kompanitë më të mëdha të risigurimit në botë dhe hapësira që ne kemi për të siguruar katastrofa, pandemi apo çdo lloj ngjarje tjetër shkon jo në miliona, por në miliarda euro.

## TREGU SHQIPTAR I SIGURIMEVE, SI KA NDRYSHUAR PAS 22 VITEVE?



22 vite nga liberalizimi i tregut të sigurimeve, sot në tregun shqiptar ka një diversifikim të portofolit të produkteve dhe shërbimeve që u ofrohen klientëve nga kompanitë e sigurimeve dhe një rritje e standartizimit të shërbimeve që i ofrohen klientëve.

Pak më shumë se dy dekada nga liberalizimi i tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe sot mund të thuhet pa frikë që tregu shqiptar operon me standarte të larta, me eksperiencë dhe modele europiane.

Dikur ekzistonte vetëm një kompani shtetërore sigurimesh derisa në vitin 1999 filluan të hapeshin kompanitë e para private, pionere e të cilave konsiderohet kompania SIGAL, e licensuar më 22 shkurt 1999.

Fillimi ishte i vështirë dhe eksperiencia dhe modelet ishin të pakta. Ndërsa sot, numërohen 11 kompani sigurimi jetë dhe jo-jetë si dhe 3 fonde private pensionesh, portofol i diversifikuar dhe mbi 50 lloj produkteve sigurimi, mund të flasim jo më për praktika e modele, por për standarte europiane dhe zhvillim të tregut. Endërsa flasim për këtë të fundit,

Shqipëria ka mbetur ende mbrapa në hartën europiane të sigurimeve, me vetëm 35 euro për frymë që harxhojnë qytetarët shqiptarë për sigurimet, krahasuar me rajonin me 300 euro për frymë apo me vendet e Bashkimit Europian, ku mesatarja e sigurimeve është 3000 euro për frymë.

E thënë ndryshe, ajo që ka ndryshuar pak, për të mos thënë aspak, është orientimi i konsumatorit shqiptar drejt tregut motorik. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që edhe pse kemi 22 vjet përvojë dhe zhvillim të tregut të sigurimeve, qytetarët shqiptarë shkojnë tek kompanitë e sigurimeve kryesisht për sigurimin e makinës që ti shmangen gjobës së policit.

Shqiptarët akoma nuk e kanë kulturën, që të sigurojnë jetën, shëndetin, pronën apo pasurinë siç ndodh në çdo vend të botës. Shfajësimi i shqiptarëve është se i kanë të ardhurat e ulëta e nuk e përballojnë dot jo vetëm koston e sigurimeve por kostot e jetesës në tërësi.

Është e vërtetë kjo, po aq sa është e vërtetë që secili prej nesh shkon minimalisht dy herë në vit në spitale për probleme

shëndetësore dhe paguan kush e di sesa para. Ndërsa nëse secili prej nesh do të ishte i siguruar, me vetëm një shumë vjetore psh 200 Euro në vit, vizitat, analizat, check-up, ndërhyrjet kirurgjikale dhe çdo shpenzim tjetër spitalor do të mbulohehin nga kompanitë e sigurimeve.

Sikundër, çdo shqiptar ka si investim parësor pronën, dhe investojnë ndoshta të gjithë kurimet e jetës për të ndërtuar një shtëpi të mirë dhe komode që i përgjigjet nevojave familjare, por harrojnë ta sigurojnë atë. Dhe kur bie tërmeti, plas bombola e gazit apo ndodh përmytja, i gjithë ky investim shkatërrohet brenda pak minutave dhe duke mos patur asnjë sigurim të banesës, mbetesh në qiell të hapur.

Prandaj dhe sigurimet nuk janë luks, por janë domosdoshmëri, që na mbrojnë financiarisht në rast aksidentesh, sëmundjesh apo fatkeqësish natyrore.

Qytetarët shqiptarë duhet të ndryshojnë mendësinë e gabuar se siguracionet janë taksa që u vendosen atyre, por duhet ti shohin sigurimet si një industri që garanton vazhdimësinë normale të jetës, pavarësisht ngjarjeve që ndodhin.





SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  
Albania

Drejtoria e përgjithshme / Head Office  
Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tirana - Albania  
Tel. (+355) 4 2233 308, Fax. (+355) 4 2250 220,  
e-mail: info @sigal.com.al, www.sigal.com.al

**Tiranë 1**  
Blv. "Zogu I", pll. Diplomatëve, nr. 57  
Tel. (+355) 2233 308

**Tiranë 2**  
Rr. Donika Kastrioti, pas Kullave Binjake  
Tel. (+355) 44 511 666

**Tiranë 3**  
Blv. Gejrgj Fishta, Komplekti Delijorgji  
Tel. (+355) 44 330 171

**Tiranë 4**  
Rr. Inbrahim Rugova, Ish-blok  
Tel. (355) 68 40 81979

**Berat**  
L. "28 nëntori"  
Tel. (+355) 32 234605

**Dibër**  
L. "Nazmi Rushiti", Peshkopi  
Tel. (+355) 218 25155

**Durrës 1**  
L. nr. 3, rr. "Skënderbej",  
qendra e Biznesit Monun  
Tel. (+355) 522 31047

**Durrës 2**  
Rruga Tregtare, Nr.42, Blv. Kryesor  
Tel. (+355) 69 365 7105

**Elbasan 1**  
L. "28 Nëntori", Rr. "11 Nëntori",  
pll.109/1, Kati 2  
Tel. (+355) 54 244446

**Elbasan 2**  
L. "Kongresi Elbasanit", Rr. "Baki  
Kongoli", shatërvani kryesor  
Tel: (+355) 69 40 96 303

**Fier 1**  
L. "1 Maji", Rr. Jani Bakalli,  
tek Kupola Center  
Tel. (+355) 69 209 3814

**Fier 2**  
L. "Apollonia", blv. "Jakov Xoxa",  
pll. 1, shk. 4  
Tel. (+355) 342 23035

**Fushë Krujë**  
Pallati hark, qendër  
Tel. (+355) 563 22869

**Gjirokastrë 1**  
L. "Punëtore", Rr. "Nacionale"  
Tel. (+355) 842 67080

**Kavajë**  
L. nr. 1, Sallbeg  
Tel. (+355) 552 42562

**Korçë**  
Blv. "Republika", pranë  
Kinema Milenium  
Tel. (+355) 822 50433

**Kukës**  
L. nr. 5  
Te. (+355) 242 24532

**Laç**  
Qendër  
Tel. (+355) 536 4578

**Lezhë**  
L. Besëlidhja, sheshi Besëlidhja  
Tel. 0215 24656

**Lushnjë**  
L. "Loni Dharmo"  
Tel. (+355) 352 21532

**Mamurras**  
Qendër  
Tel. (+355) 69 20 25 829

**Mat**  
L. "Partizani", Burrel  
Tel. (+355) 217 22746

**Përmet**  
Shëtitorja "Odhise Paskali"  
Tel. (+355) 813 23293

**Pogradec**  
L. Nr 2 Rr., "Rinia", pallati 80  
Tel. (+355) 832 26792

**Pukë**  
Rr. "Imer Puka", blloku nr. 1  
Tel. (+355) 212 22880

**Rrëshen**  
Sheshi "Abat Doçi", Mirditë  
Tel. (+355) 69 20 74 581

**Sarandë**  
L. nr. 1, rr. "Flamurit", nr. 19  
Tel. (+355) 852 25045

**Shkodër 1**  
L. "Vojo Kushi", Rr. "Çlirimi",  
pranë teatrit "Migjeni", Kati II  
Tel (+355) 222 44429

**Shkodër 2**  
L. "V.Shanto", Rr. "Çajupi", pll.  
Fishta 2  
Tel. (+355) 222 49680

**Tropojë**  
Qendër, Bajram Curri  
Tel. (+355) 213 23101

**Vlorë**  
L. Pavarësia, Qendra Tregtare  
Riviera  
Tel. (+355) 332 23121



SIGAL UNIQA  
Group AUSTRIA  
Kosova

Drejtoria  
Rr. "Ukshin Hoti", Pejton, 10,000, Prishtinë – Kosovë,  
Tel. (+383) 38 240 241, E-mail: info @sigal-ks.com,  
www.sigal-ks.com

**Prishtinë**  
Rr. "Dëshmorët e Kombit",  
nr. 72/a, Lagja Ulpian  
Tel. (+381) 38 550 576

**Ferizaj**  
Rr. "William Wolker" p.n  
Tel. (+381) 290 320 536

**Gjakovë**  
Rr. "E Tiranës" p.n  
Tel. (+381) 44 188 354

**Gjilan**  
Rr. "Adem Jashari"  
Tel. (+381) 280 320 810

**Mitrovicë**  
Rr. "Adem Jashari" p.n  
Tel. (+381) 44 263 742

**Pejë**  
Rr. "Mbretresha Teutë" p.n  
Tel. (+381) 39 420 092

**Prizren**  
Rr. "William Woker" p.n  
Tel. (+381) 29 244 024

UNIQA  
Maqedoni

Drejtoria  
Blv. "Ilinden", Nr.1, Shkup, Maqedoni  
Tel. (+389) 2 3109 060, Fax. (+389) 2 3215 128,  
E-mail: info@uniqa.mk, www.uniqa.mk

**Shkup**  
Xhon Kenedi, nr. 27  
Tel. (+389) 2 2621 211

**Berovë**  
Marshal Tito nr. 115  
Tel. (+389) 75 811 801

**Delcevo**  
Nikola J. Vapcarov  
Tel. (+389) 75 309 005

**Dibër**  
Bratstvo Edinstvo  
Tel. (+389) 46 835 145

**D. Hisar**  
Goce Delcev Nr.9A  
Tel. (+389) 47 275 000

**Gostivar**  
Dimitar Vlaho  
Tel. (+389) 42 221 046

**Gjevgjeli**  
7 Noemvri  
Tel. (+389) 34 218 568

**Kavadar**  
Ilidenska nr. 115  
Tel. (+389) 34 400 288

**Kërcovë**  
Kuzman Jusfovski Pitu  
Tel. (+389) 45 224 290

**Koçan**  
Marshal Tito 86 A  
Tel. (+389) 33 272 150

**Kriva Palanka**  
Marsal Tito nr.230a  
Tel. (+389) 31 372 182

**Kumanovë**  
Potok Serava nr. 2  
Tel. (+389) 31 437 187

**Manastir**  
Stalarska  
Tel. (+389) 47 203 646

**Negotivë**  
Marshal Tito nr. 43  
Tel. (+389) 43 370 590

**Ohër**  
Bul. Turisticka bb zgr.  
Remis Kifla  
Tel. (+389) 46 231 616

**Prespë**  
Leninova  
Tel. (+389) 47 453 000

**Prilep**  
11 Oktomvri Lam.A 8  
Tel. (+389) 48 427 657

**Probishtip**  
Hristjan T. Karposh  
Tel. (+389) 32 480 860

**Radovish**  
Marsal Tito nr.23  
Tel. (+389) 32 630 309

**Strugë**  
JNA  
Tel. (+389) 46 783 201

**Strumicë**  
Mladinska Nr. 45  
Tel. (+389) 34 430 083

**Shën Nikollë**  
Ilined  
Tel. (+389) 32 444 045

**Shtip**  
Tosho Arsov nr. 38  
Tel. (+389) 32 389 710

**Tetovë**  
Ilindenska, nr. 51  
Tel. (+389) 44 351 630

**Veles**  
Strasho Pinxhur nr. 6  
Tel. (+389) 32 43 211 806

**Vinice**  
Ilidenska  
Tel. (+389) 33 364 559





#### SHQIPËRI

SIGAL Business Center  
Blv: "Zogu I", Nr. 1, Tirana, Albania  
Tel: (+355) 4 2233 308, Fax: (+355) 4 2250 220  
e-mail: info@sigal.com.al, www.sigal.com.al

#### KOSOVË

Rr. "Vaso Pasha", p.n. Pejton, 10 000,  
Pristine, Kosova  
Tel: (+381) 38 240 241, Fax: (+381) 38 240 241 123  
e-mail: info@sigal-ks.com, www.sigal-ks.com

#### MAQEDONI E VERIUT

Rr. "Marks & Engels" 3, 1000  
Skopje, Macedonia  
Tel: (+389) 2 3125 920, Fax: (+389) 2 3215128  
e-mail: info@uniqa.mk, www.uniqa.mk